



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në

“Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

Universiteti “Metropolitan Tirana”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Drini SALKO

2. Prof. As. Dr. Besnik KRASNIQI

Dhjetor/2020

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **Për Programin e studimit: Master i Shkencave në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”, ofruar nga Universiteti “Metropolitan Tirana”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Metropolitan Tirana”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë-Bankë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 709, datë 19.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE / 8 PAK
18	Numri i studentëve:	10
19	Komente / të tjera:	

# PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës;

Universiteti “Metropolitan Tirana” (UMT) është institucion jo publik i Arsimit të Lartë, i krijuar me VKM Nr.357, dt.12.05.2010 fillimisht me dy njësi kryesore:Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti i Ekonomisë.

Pas miratimit të statusit të tij si universitet me Urdhër Nr.611, date 28.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, UMT është akredituar institucionalisht me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.45, date 05.07.2019. Ndërkohë, me Urdhër Nr. 195, datë 01.04.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është bërë riorganizimi në UMT me 3 njësi kryesore, konkretisht:Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës.

Veprimtaria e UMT bazohet në aktet ligjore, nënligjore dhe rregulluese në fuqi qëpërcaktojnë qartë rolet e autoriteteve drejtuese të institucionit.

Fakulteti i Ekonomisëpërfshin tre njësi bazë: Departamentin Financë-Bankë, Departamentin e Shkencave Administrative dhe Departamentin e Informatikës Ekonomike.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” mbulohet nga Departamenti Financë-Bankë. Ky program është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019, bazuar në Urdhrine MASR Nr. 709, datë 19.10.2018. Programi i studimit realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike/4 semestra dhe në përfundim të tij lëshohet diplomë e nivelit të dytë “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kyprogram studimi me histori 2 vjeçare, që pret të diplomojë brezin e parë të studentëve,është në proces akreditimi për herë të parë.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Prof.Dr. Drini Salko dhe Prof.As. Besnik Krasniqi, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, mbështetur në këtë proces ngakoordinatori teknik i ASCAL, Msc. Ersi Dako, në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm, u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërben Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin e Ekonomisë, Departamentin Financë-Bankë. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita në vend që u realizua pranë UMT në datat 30 Shtator dhe 1 Tetor 2020. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin (UMT), u realizuan takime me drejtues të njësisë kryesore/bazëe struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi.

Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me: Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjës të Departamentit Financë-Bankë, Grupin e Vetëvlerësimit, Stafin akademik që mbulon programin e studimit, Studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Kurrikulës dhe Cilësisë, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrën e Shërbimit të Studentëve, Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrën e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu, u realizua një vizitë edhe në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, sallën e kompjuterëve, bibliotekë, etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj.

Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tonapër dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv.

Më datë 05.11.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 18/20 Prot., datë 05.11.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, më datë 20.11.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 138/1 Prot., datë 20.11.2020, përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. GVJ, pasi shqyrtoi me seriozitet komentet e IAL, shprehet si vijon:

### **1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.5, kriteri 5**

**Komenti në RVJ:** *Megjithatë, mendojmë se duhet të rritet më tej numri i marrëveshjeve me Universitete homologe të huaja.*

**Komenti i IAL:** Referuar strategjisë së UMT (evidenca 3: UMT Plani strategjik i zhvillimit të UMT, dorëzuar në mbështetje të RVB), si dhe në frymën e ndërkombëtarizimit të institucionit tonë, numri i marrëveshjeve ka një trend rritës në vitet e fundit. Kjo falë dhe përfshirjes së UMT në projekte ndërkombëtare (Erasmus +, projekti MARDS etj). Është në prioritetet e UMT, siç u shprehën dhe titullarët e Fakultetit të Ekonomisë gjatë vizitës në vend, rritja e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e numrit të marrëveshjeve me institucione të arsimit të lartë homologe. Në rast se do kërkohej nga ekspertët, mund të vihej në dispozicion një dokument zyrtar nga UMT për këtë qëllim.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në listën e marrëveshjeve që ka IAL me universitete homologe të huaja, ky numër konsiderohet i ulët.

## 2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.5, kriteri 6

**Komenti në RVJ:** *Departamenti Financë-Bankë nuk harton raporte të veçanta lidhur me bashkëpunimin me entet e ndryshme. GVJ shqyrtoi raportet periodike të analizës mësimore shkencore të Departamentit, ku në to përfshihet edhe analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me entet e ndryshme.*

**Komenti i IAL:** Ka një pasaktësi në fjalinë e parë, pasi fjalia e dytë konfirmon bazuar në evidencë kriterin përkatës.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në përcaktimin e kriterit kërkohet të verifikohet përgatitja e raporteve analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit nga njësia përgjegjëse e programit, gjë që nuk na rezulton.

## 3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.1, kriteri 1

**Komenti në RVJ:** *Duke shqyrtuar planin mësimor të këtij programi studimi, konstatohet që secila nga 15 lëndët e përfshira në program, është vlerësuar me 6 kredite. GVJ mendon që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperiencën të programeve në Universitete të tjera, numri i krediteve të përcaktuara, duhet të luhet në funksion të ngarkesës (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit. Në këtë gjykim, lëndë të caktuara karakterizuese mund të kenë një numër kreditesh me të lartë se të tjerat, kjo rrjedhë e vështirësive apo orëve të angazhimit jashtë auditorit, që për lëndë të ndryshme mund të jenë më shumë.*

**Komenti i IAL:** Lidhur me metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndë, bazuar në aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë, si dhe në eksperiencat e universiteteve me të cilat kemi

marrëveshje, UMT ka të përcaktuar qartë metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndë (referuar proceseve të akreditimit të programeve të studimit që ka kryer UMT deri më tani).

Në vlerësimin në përmbajtje të programit të studimit në kuadër të licensimit (me ekspertë të fushës të përzgjedhur nga MASR nga listat e ASCAL), nuk kanë lënë rekomandime të kësaj natyre. Në këtë kontekst, Fakulteti i Ekonomisë në UMT, e ka zhvilluar programin e studimit konform aktit të licensimit të tij nga MASR.

Struktura e planit mësimor të programit të studimit është plotësisht në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, për sa i përket peshës në kredite sipas tipologjisë së lëndëve.

Vëmë në vëmendjen Tuaj, se referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndryshimet në një program studimi (plan mësimor), bëhen pasi programi ka kaluar fazën e testimit të tij konkret dhe akreditimit të parë të programit, për të bërë përmirësimet konkrete, që është dhe qëllimi parësor i këtij procesi.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi konstatimi bazohet në logjikën e ngarkesës së lëndëve të cilat nuk mund të jenë të njëjta për shkak të natyrës apo fushës që ato përfshijnë në trajtim. Ky është një konstatim i GVJ bazuar në njohjen e përcaktimit të krediteve për lëndët dhe eksperiencës në mjaft universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Nga ana tjetër, GVJ nuk thekson shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me këtë çështje.

#### **4. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.1, kriteri 7**

**Komenti në RVJ:** Në modelin e diplomës të përcjellë në Dosjen e Vetëvlerësimit, ka një pasaktësi në emërtimin e programit, pasi është paraqitur vetëm “Inxhinieri Financiare”. Kjo gjë u diskutua edhe gjatë vizitës në institucion me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe u pranua prej tyre saktësimi në të ardhmen i këtij gabimi teknik.

**Komenti i IAL:** Së pari sqarojmë se modeli i diplomës të një programi studimi që ofron një IAL regjistrohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, MASR, vetëm pas përfundimit të procesit të akreditimit të parë të programit të studimit (Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe specifikisht Udhëzimit nr.10, datë 30.03.2020 i Ministrisë përgjegjëse për arsimin).

Pra, formati ligjor i diplomës së programit të studimit miratohet mbas akreditimit të programit të studimit dhe fiton efekt ligjor vetëm mbas regjistrimit në Regjistrin Shtetëror të QSHA, MASR dhe kalon në një procedurë specifike sipas Udhëzimit nr. 10/2020 të MASR.

Në këtë kontekst, draft modeli i diplomës i paraqitur në DVV, është më shumë orientuese lidhur me elementët e saj (bazuar në modelet në tërësi të formave të diplomave në UMT) dhe nuk është detyrim si dokumentacion përbërës i DVV.

Drejtuesi i njësisë kryesore dhe njësisë bazë kanë pranuar saktësimin e emërimit, i cili është lapsus. Nisur nga fakti se modeli i diplomës nuk ka fituar akoma efekt ligjor por është paraqitur thjesht për ilustrim paraprak e vizual, mendojmë se ky konstatim nuk përbën shkak për mos plotësim kriteri.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi pranohet nga IAL si një lapsus në emërimin e diplomës, por që nuk ka fituar efekt ligjor dhe që është plotësisht e rregullueshme. Për sa më lart, nevojitet që IAL të saktësojë modelin e diplomës përpara përcjelljes së saj për miratim në QSHA. Ky koment, me qëllim saktësimi të mëtejshëm, është shtuar dhe në kriterin përkatës.

Lidhur me komentin e IAL se modeli i diplomës nuk është detyrim për tu paraqitur si dokumentacion përbërës i DVV, GVJ konkludon se, bazuar në modelin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në kuadër të akreditimit për herë të parë, për programet e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave/Arteve, të publikuar nga ASCAL, në pjesën ku paraqitet “*Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit*” (fq. 39), një nga dokumentat e detyrueshme që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programit të studimit, është edhe Modeli i diplomës dhe Modeli i Suplementit të Diplomës (dokumenti nr. 15).

## 5. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.3, kriteri 3

**Komenti në RVJ:** Programi përfshin një numër total prej 120 ECTS dhe është i ndarë në strukturë në orë në auditor, orë në aktivitete të tjera si projekte, orë studimi individual, elemente këto matës të sistemit ECTS. Ngarkesa mësimore prej 1800 orësh është e ndarë në mënyrë të barabartë në katër semestrat e vitit akademik. Sikurse përmendur edhe më sipër, këto elementë të ngarkesës janë të njëjtë për çdo lëndë, gjë që mund të mos ketë marrë në vlerësim lëndë të cilat mund të kërkojnë më shumë angazhim se të tjerat.

Mendojmë që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve, për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperiencë të programeve në universitete të tjera, numri i krediteve të përcaktuara për lëndë të caktuara që janë 6 kredite, të mund të ulet në 3 apo 4 kredite, dhe për lëndë karakterizuese si “*Inxhinieria Financiare*” apo “*Modelingu Financiar*” të rritet. Kjo, rrjedhojë e vështirësive apo orëve të angazhimit jashtë auditorit që për lëndët e propozuara mund të jenë më shumë. Aneks 53; Aneks 54; Aneks 56.

**Komenti i IAL:** Shih komentin për Standardin II.1, kriteri 2, më sipër. Sqarojmë se Fakulteti i Ekonomisë në UMT, e ka zhvilluar programin duke respektuar licencimin e tij nga MASR. Deri në akreditimin e programit nuk lejohet aplikimi i ndryshimeve. Institucioni është i gatshëm të

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

*Dimitri Spalke*

diskutojë dhe shqyrtojë rekomandimet e ekspertëve lidhur me këtë pikë, pasi të kemi bërë vlerësimin e programit dhe të kemi nxjerrë konkluzionet përkatëse, në përfundim të procesit të akreditimit të programit. Mendojmë se bazuar në aktet ligjore (autonomia dhe liria akademike e institucioneve), në aktet nënligjore (VKM 41/2018, i ndryshuar), UMT përmbush plotësisht kërkesat e këtij kriteri.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në përcaktimet e këtij kriteri kërkohet konfirmimi i përmbajtjes së programit me numër kreditesh sipas kriterëve të caktuara, gjë që konfirmohet. Sugjerimet e GVJ mbi ndryshimet në numër kreditesh për lëndë të veçanta në këtë program i shërbejnë përmirësimit të tij në procesin e vlerësimit të programit dhe lirisë akademike. Ky koment, me qëllim saktësimi të mëtejshëm, është shtuar dhe në kriterin përkatës. Nga ana tjetër, GVJ nuk thekson shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me këtë çështje.

## 6. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.3, kriteri 5

**Komenti në RVJ:** *Studentët kandidatë për tu regjistruar në këtë program si dhe ata që vazhdojnë procesin mësimor marrin informacion mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve nëpërmjet:*

- Rregullores së studimeve të UMT
- Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë
- Rregullores së programit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”.

*Mendojmë se, në kuadër të mundësive të rritjes së regjistrimeve të reja në këtë program, institucioni duhet të japë informacion edhe drejtpërdrejtë në takime me të diplomuarit në sistemin Bachelor, jo vetëm në fushën e Ekonomisë, por edhe ata që janë diplomuar në shkencat ekzakte inxhinerike dhe informatike që kanë një treg punësimi pothuajse të sigurt me përfundimin e këtij programi.*

**Komenti i IAL:** Jemi plotësisht dakord me sugjerimin e Ekspertëve të jashtëm për dhënie informacioni dhe për takime me studentët bachelor për rritjen e regjistrimeve, por nuk mendojmë se ky fakt e penalizon vlerësimin e këtij kriteri nga plotësisht në kryesisht. Kjo praktikë është ndjekur dhe po ndiqet edhe aktualisht. Gjithashtu, në funksion të promovimit të programit të studimit, është zhvilluar një fushatë e posaçme marketimi, e cila i pajis kandidatët me informacionet e nevojshme për programin e studimit, në rrjetet sociale UMT, në ëebseiten e institucionit etj. (aneksi 1: print screens)

Në vlerësimin tonë, afati kohor i aktivizimit të programit të studimit (vetëm 2 vite akademike) ka kondicionuar numrin e studentëve të regjistruar, numër ky i pritshëm nga analiza paraprake për ecurinë e programit, fakt ky që favorizon në aspektin e cilësisë për ofrimin e programit. Aktualisht jemi në fazën e procesit të pranimit të studentëve në këtë program studimi për vitin akademik 2020-2021, dhe shihet një trend rritës në numrin e aplikimeve (100%).



Përfundimi jo në kohë i procesit të akreditimit (duhet të përfundonte në korrik 2020) për shkak të mbylljes së institucioneve nga situata COVID-19 (referojuni komunikimit të ASCAL me UMT në AMS), pritet të impaktojë dhe numrin e aplikantëve në këtë program. Jemi të bindur, nga eksperiencia disavjeçare në menaxhimin e programeve të studimit pranë UMT, se mbas akreditimit, numri i studentëve do të rritet ndjeshëm. Në këtë kontekst vlerësojmë se kriteri përmbushet plotësisht.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi sugjerimet e dhëna në RVJ kanë si qëllim rritjen e prurjeve të reja me një marketing më intensiv, por që do ketë efekt më të lartë nëse programi është i akredituar. Ky koment, me qëllim saktësimi të mëtejshëm, është shtuar dhe në kriterin përkatës.

## 7. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, kriteri 7

**Komenti në RVJ:** *Programi Msc. ne “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” I pajis studentet qe zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri me te thelluara teorike dhe praktike te fushës se menaxhimit te riskut si dhe te aplikimeve te modeleve dhe programeve te informatikës ne fushën e financës.*

*Gjithashtu, ky program u jep mundësi studenteve qe mbarojnë studimet ne inxhinieri apo matematike, te specializohen me njohuri te avancuara te përdorimit te inxhinierisë financiare ne sektorin financiar, kryesisht privat, duke u dhënë me shume mundësi ne tregun e punës, sidomos ne sektorin privat.*

*Për të realizuar këtë objektiv të fundit, rekomandohet futja në program për këtë kontingjent studentësh i lëndëve bazë në financë, mikroekonomi, kontabilitet, etj.*

**Komenti i IAL:** Siç kemi komentuar me lart (Standardi II.1 dhe II.2) sqarojmë se Fakulteti i Ekonomisë në UMT, e ka zhvilluar programin duke respektuar licencimin e tij nga MASR, dhe gjithashtu ka pasur në konsideratë vazhdimësinë e studimeve nga niveli bachelor në nivelin master. Rekomandimi i ekspertëve është zgjerimi i kontingjentit të hyrjeve, gjë që do të merret në konsideratë nga ana jonë, por ky konstatim nuk çënon përmbushjen e objektivave të programit të studimit dhe të standardit aktual, ku hyrjet e studentëve kane qenë nga Fakultetet Ekonomike, në zbatim edhe të rregullores së programit të studimit. Pas akreditimit, Departamenti përgjegjës dhe Fakulteti i Ekonomisë janë të gatshëm të aplikojnë rekomandimet e ekspertëve. Por, përsa kohë programi i studimit përmbush objektivat e tij në përputhje me ciklin e studimit që mbulon, brenda kuadrit ligjor dhe në zbatim të procedurave të parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, mendojmë se kriteri përmbushet plotësisht.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në këtë kriter, pavarësisht se programi i plotëson kërkesat e përmbajtjes së njohurive të thelluara në fushën e ekonomisë dhe financës, për një efikasitet më të mirë për studentët e ardhur nga shkencat

inxhinerike, rekomandohet marrja e njohurive shtesë me lëndë bazike të financës mikro dhe makroekonomisë. Ky koment, me qëllim saktësimi të mëtejshëm, është shtuar dhe në kriterin përkatës.

## 8. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ ne Standardin II.5, kriteri 2

**Komenti në RVJ:** Nisur nga treguesi i ngarkesës mësimore të stafit PAE, pedagogë të caktuar mbulojnë nga 3 deri në 5 lëndë. Nisur nga sa më sipër, do të ishte në interes të rritjes së nivelit të cilësisë së mësimdhënies, rritja e numrit të stafit me kohë të plotë nëpërmjet rekrutimeve të reja, me qëllim mbulim optimal të numrit të lëndëve nga pedagogët.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se disa titullarë të lëndëve në këtë program janë personel me gradë shkencore Doktor. Institucioni duhet të angazhojë staf akademik të kategorisë “Profesor”, sikurse është kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

**Komenti i IAL:** Jemi dakord me konstatimin e GVJ dhe sugjerimet e tyre që të rritet cilësia e pedagogëve që japin mësim në këtë master, duke caktuar pedagogë më tituj dhe grada më të larta. Por theksojmë se ngarkesa akademik e pedagogëve në këtë program studimi është realizuar konform kuadrit nënligjor në fuqi (Udhëzimi nr. 29, datë 10.9.2018 e MASR, ndryshuar me Udhëzimin nr. 37, datë 4.12.2018), ku një pedagog i brendshëm mund të mbulojë deri në 6 lëndë gjatë një viti akademik dhe në bazë të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë, stafi akademik që jep mësim në një program studimi duhet të ketë një gradë më lartë. Përveç se ky kriter ligjor është përmbushur plotësisht, Fakulteti i Ekonomisë, bazuar në kualifikimin dhe backgroundin akademik të stafit, i ka angazhuar në procesin e mësimdhënies akademik në përputhje me fushës specifike të lëndës/ve që mbulojnë.(Evidencë nr 61, Evidencë nr 61.1 CV e stafit akademik, Tabela nr 12,Tabela nr 6, DVV). Ndërkohë që titullarët janë aktualisht të kategorisë profesor dhe në vlerësimin tonë ky kriter përmbushet plotësisht. *Sqarim: Në fillim vitin akademik 2020-2021, FE ka rekrutuar staf të ri akademik me tituj/grada.*

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në aktet nënligjore dhe analizën e stafit që mbulon këtë program, evidentohet një gjetje e tillë dhe IAL duhet të këtë parasysh rekomandimet e dhëna.

## 9. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.2, kriteri 3

**Komenti në RVJ:** Nuk na rezulton të jetë organizuar ndonjë trajnim specifik apo të parashikohet një organizim i një programi të caktuar në lidhje me kualifikimin e stafit në shkrim projektesh apo në avancimin e metodikave inovative të mësimdhënies, pedagogjisë etj.

**Komenti i IAL:** Fakulteti i Ekonomisë, ka aplikuar shkëmbim eksperience lidhur me metodat e mësimdhënies që synojnë të aftësojnë më shumë pedagogët në këtë proces. Kjo është konsideruar si formë e trajnimit në drejtimin e kërkuar. Shkëmbimi i eksperiencave në

programin Erasmus + për stafin akademik, ofron trajnim të mëtejshëm të stafeve tona akademike.

1. Organizimin e Javës së inovacionit – javë leksionesh të hapura për stafin dhe studentët
2. Listën e stafit që kanë marrë pjesë në shkëmbimet Erasmus +.
3. Listën e leksioneve të hapura të Fakultetit të Ekonomisë për vitin akademik 2019-2020.

Referuar vlerësimit nga grupi i eksperteve të jashtëm si dhe argumentit të gjykojmë se ky kriter përmbushet plotësisht.

(Evidencë nr 28, Evidencë nr 93, Evidencë nr 99, Evidencë nr 101. DVV).

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në verifikimin dhe analizën nga GVJ nuk rezulton që IAL të këtë organizuar veprimtari specifike lidhur me metodologjinë dhe pedagogjinë e mësimdhënies apo metodave inovative në këtë drejtim.

#### **10. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.4, kriteri 1**

**Komenti në RVJ:** Bazuar në dokumentacion dhe vizitën në institucion, u konstatua se në dispozicion të studenteve vihet edhe Biblioteka, e vendosur në godinën nr 1. të Fakultetit të Ekonomisë. Në mjediset e kësaj Biblioteke studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. Orari dhe shërbimi i ofruar është në funksion të nevojave të studentëve. Mjediset e Bibliotekave janë të hapura edhe në fundjavë. Kjo bibliotekë ofron mundësinë e kërkimit dhe gjetjes së librave online në sallën e leximit në kompjuterin e vendosur për këtë qëllim. Megjithatë, mendojmë se hapësira e këtij mjedisi është jo optimale në funksion të qëllimit të saj.

**Komenti i IAL:** Aktualisht numri i studentëve në këtë program studimi është akoma i vogël dhe ambientet e bibliotekës janë të mjaftueshme. Në perspektivë UMT, ka marrë masa të plota për të siguruar ambiente të mjaftueshme, pasi ka marrë lejen e ndërtimit të kompleksit të ri universitar i cili zgjidh të gjitha problemet infrastrukturore.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në verifikimin gjatë vizitës në institucion, GVJ gjykoj se hapësira e mjedisit të bibliotekës duhet të ishte më e madhe, pasi ajo është në shërbim të të gjithë studentëve të Fakultetit të Ekonomisë.

#### **11. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.4, kriteri 2**

**Komenti në RVJ:** Ka libra në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj megjithatë, u konstatua se për disa fusha, mungonte literatura dhe në disa libra, tekste universitare, numri i ekzemplarëve ishte shumë i limituar, pa harruar që në ndonjë disiplinë mungonin ekzemplarët. Rekomandojmë shtimin e fondit të librave me tekste në shqip por edhe në anglisht për lëndët karakterizuese të

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423



*programit, me qëllim që leksionet e parashkruara që janë përgatitur nga stafi të plotësohen me këto tekste.*

**Komenti i IAL:** Plotësisht dakort me sugjerimin e Ekspertëve të jashtëm për shtimin e fondit të librave me tekste në shqip por edhe në anglisht për lëndët karakterizuese të programit, por nuk mendojmë se ky fakt e penalizon vlerësimin e këtij kriteri nga plotësisht në kryesisht. Kjo për faktin se numri i teksteve disponibël është plotësisht i mjaftueshëm për numrin e studentëve që ka programi dhe gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe bibliotekën elektronike dhe burimet e internetit, ky fakt nuk ndikon në uljen e cilësisë së procesit mësimor.

Nga ana tjetër sqarojmë se së bashku me rritjen e kapaciteteve janë marrë masa edhe për mjetet didaktike dhe leksionet. Në këto kushte vlerësojmë se kriteri përmbushet plotësisht.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në verifikimin gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionin e përcjellë, GVJ gjykon se fondi aktual i teksteve, sidomos për lëndët karakterizuese të këtij programi, është i pamjaftueshëm.

## **12. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.6, kriteri 5**

**Komenti në RVJ:** *Për një qëndrueshmëri financiare të UMT, mendojmë se rritja e numrit të studentëve të regjistruar përben dhe drejtimin kryesor, sfidën me të madhe për arritjen e këtij objektivi, pasi numri tepër i kufizuar i studentëve aktual gjatë dy viteve të fundit (10 studentë) është tregues i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e programit.*

**Komenti i IAL:** Jemi plotësisht dakord me sugjerimin Ekspertëve të jashtëm se rritja e numrit të studentëve të regjistruar përben dhe drejtimin kryesor, por nuk mendojmë se ky fakt e penalizon vlerësimin e këtij kriteri. Referuar dhe argumentimit në standardin II.3, kriteri 5 i GVB, numri i aplikimeve në këtë program është me trend rritës të qëndrueshëm, pavarësisht mospërfundimit në kohë të akreditimit të programit.

Në mbështetje të argumentit të sipërcituar, theksojmë se në asnjë rast të ekzistencës të UMT (prej 10 vitesh si institucion i arsimit të lartë) nuk është konstatuar problem i ndërprerjes së financimit nga ana e aksionerit në rast nevojë.

Që në analizën për hapjen e një programi studimi, nga ana financiare investitori merr në konsideratë faktin që 3-5 vitet e para, programet e reja të studimit do të financohen nga të ardhurat e mundësuar nga programet e tjera të studimit të Fakultetit të Ekonomisë. Përsa kohë numri i studentëve është në rritje, nga viti në vit, ky program studimi do të rritë të ardhurat e tij. Vlerësimi financiar kryhet minimalisht në nivel fakulteti, ku të ardhurat e programeve aktuale disavjeçare në treg, mundësojnë investimin për hapjen e programeve të reja, proces ky që përveç që evidenton zgjerimin dhe forcimin e UMT, bën të mundur ofrimin e programeve të reja të studimit, për të cilat ka kërkesë gjithmonë e në rritje tregu i punës apo të ofroje programe që i

mungojnë, dhe janë unike ne vend, siç është rasti i MSC IMFR. Ne këto kushte ne vlerësimin tonë, kriteri përmbushet plotësisht.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që, bazuar në faktin që qëndrueshmëria financiare e IAL (pra në nivel Fakulteti/Universiteti) nuk rrezikohet, raporti në këtë pikë **ndryshon**. Rekomandimi i GVJ lidhet me intensifikimin e punës në kuadër të rritjes së numrit të studentëve në të ardhmen e afërt. Analiza e GVJ për këtë kriter ndryshon si në vijim: *“Pavarësisht qëndrueshmërisë financiare të IAL (pra në nivel Fakulteti/Universiteti) e cila nuk ka pasur problem deri tani, rritja e numrit të studentëve në të ardhmen afatshkurtër do të sigurojë qëndrueshmërinë e programit dhe do kontribuonte më tej në qëndrueshmërinë financiare të institucionit”*. Gjithashtu, vlerësimi për këtë standard ndryshon në “përmbushet plotësisht”, dhe për rrjedhojë ndryshon edhe vlerësimi për fushën dhe vlerësimi tërësor në “përmbushet plotësisht”.

### **13. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.1 paragrafi i fundit**

**Komenti në RVJ:** *Mendojmë se NJSBC do të duhet që institucioni të hartojë politika më të plota dhe më të detajuara lidhur me ngritjen e mëtejshme të cilësisë së programeve të studimit që zhvillohen në institucion dhe natyrisht edhe për këtë program që GVJ po vlerëson.*

**Komenti i IAL:** Bazuar në evidencat e dorëzuara në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) përkatësisht Aneksi3; Aneks 7; Aneks 8; Aneks 9; Aneks 13 (të cituara dhe nga GVJ), dhe përshkrimin të kriterëve në RVB tek standardi VI, institucioni ka të hartuara qartazi politikatat cilat synojnë në rritjen e vazhdueshme të cilësisë duke respektuar standardet, për të siguruar një fleksibilitet në zhvillimin institucionit dhe të programeve të studimit. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë (NJSBC, njësitë kryesore, njësitë bazë, strukturat ndihmëse me karakter akademike dhe administrativ, asambleja e personelit akademik, studentët, Alumni, partnerët; Kodi i Cilësisë, plani i zhvillimit strategjik të UMT në vite, Rregullore e UMT, rregullore e funksionimit të NJSBC, procedura të organizimit të procesit mësimor, rishikimit të programeve të studimit, hartimi dhe kryerja e pyetësorëve me studentët, vlerësimi i performancës të stafit akademik, analiza analitike për aspekte të ndryshme të cilësisë, plane masash në nivel njësie kryesore dhe universiteti me veprimtari të planifikuara me afate, strukturën përgjegjëse, mënyrën dhe formën e raportimit të realizimit të veprimtarisë së planifikuar) përgjatë 10 viteve të ekzistencës të UMT, është ngritur, konsoliduar mbi sfida dhe eksperiencat konkrete lidhur me sigurimin e cilësisë së brendshme si në nivel institucional ashtu në nivel programesh. Përveç se këto politika janë të sanksionuara në aktet themelore të universitetit: Statut, Planin e zhvillimit strategjik apo dokumente specifike që lidhen në mënyrë direkte me përgjegjësinë institucionale sipas njësive/strukturave përkatëse për konsolidimin e cilësisë, por janë parashikuar dhe mekanizmat me të cilat kjo arrihet. Përcaktimi në nivelet më të larta të menaxhimit të institucionit të një zv/rektori të dedikuar për cilësinë, me synimin e plotësimin të objektivave strategjike të UMT lidhur me sigurimin e brendshme të cilësisë.

Siç e kemi dokumentuar ne DVV apo dhe cituar në RVB, institucioni ka kryer mbi 15 procedura vlerësimi të jashtëm në kuadër të akreditimeve të programeve të studimit që ofron, dhe mbi 3 vlerësime të jashtme ne kuadër të akreditimit institucional (akreditim institucional me QAA-ASCAL). Këto procese vlerësimi dhe akreditimi (me kohëzgjatje maksimale akreditimi) nuk janë konsideruar nga institucioni vetëm si një plotësim i kërkesave ligjore, por si procese ciklike në funksion të përmirësimit të cilësisë në të gjitha aspektet akademik dhe institucione të UMT. Në këtë kontekst, vlerësojmë se UMT ka dhe zbaton politika të qarta për sigurimin e cilësisë si në nivel institucional ashtu dhe në nivel programesh.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në dokumentacionin e përcjellë dhe analizën tonë, NJSBC-ja nuk ka hartuar politika të qarta dhe më të detajuara lidhur me rritjen e cilësisë së programeve të studimit, përfshirë edhe këtë program.

#### 14. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.3, paragrafi i fundit

**Komenti në RVJ:** *Vetë historiku i shkurtër i këtij programi e bën të domosdoshëm monitorimin më të thelluar në të ardhmen dhe vlerësimin më të saktë për këtë program, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tij në funksion jo vetëm të rritjes së numrit të studentëve të ardhshëm në program, por dhe të thithjes nga tregu i punës të kontingjentëve të studentëve të diplomuar, dy sfidat kryesore të tij.*

**Komenti i IAL:** siç është cituar në RVB, standardi VI.3, në dokumentacionet për analiza të NJSBC bashkëlidhur DVV apo takimeve me GVJ, procedurat e ndjekura për monitorimin e cilësisë të programeve të studimit që ofron UMT, përfshirë dhe programin në vlerësim janë: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimet e provimeve apo detyrave të studentëve, janë realizuar me takime të drejtpërdrejta apo pyetësorë me studentë, nëpërmjet komisioneve ad hoc (shih stand. VII dhe 2). Vlerësime këto të vazhdueshme, semestralë dhe vjetore për secilin program studimi.

Konkretisht, për programin e studimit Msc në IMFR (aktivizuar vetëm 2 vite akademike) është bërë vlerësimi vjetor në vitin e parë të aktivizimit të tij (shih Raportet Vjetore të FE, bashkëlidhur DVV) dhe këtë vit në kuadër të akreditimit është bërë një analizë e hollësishme e cila ka konkluduar në RVB e këtij programi.

Referuar dhe frymës së RVB, qëllimi parësor i procesit të vlerësimit nuk është vetëm përmbushja e kriterëve ligjore lidhur me akreditimin e programit, por analizë e situatës faktike të zhvillimit të tij. Përsa i përket rritjes së numrit të studentëve në këtë program, siç kemi cituar më lart, në këtë vit akademik ka një trend rritës të të regjistruarve sipas pritshmërisë që kemi. Vlerësojmë se standardi përmbushet plotësisht.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi, sikurse përmendur dhe në analizën e GVJ, rekomandimi ka të bëjë me periudhën afatshkurtër të

programit dhe përmirësimin e mëtejshëm në të ardhmen për rritjen e numrit të studentëve në këtë program. Ky koment, me qëllim saktësimi të mëtejshëm, është shtuar dhe në kriterin përkatës.

#### 15. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.4, kriteri 4

**Komenti në RVJ:** *Për një ndjekje, monitorim dhe vlerësim me të mire të këtij programi, por jo vetëm, do të rekomandonim ngritjen e një Komisioni të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në nivel Fakulteti të Ekonomisë, që të këtë në përbërje staf të njësisë kryesore (Fakultetit) dhe studente të këtij programi mësimor. Kjo do të rriste me tej përgjegjësinë por dhe profesionalizmin në monitorim, por para se gjithash në vlerësimin e cilësisë së programit. Po kështu, të mundësohet marrja e opinionëve dhe vlerësimeve nga eksperte të jashtëm që e njohin këtë fushë studimi dhe që kanë eksperience në vlerësim programesh dhe monitorim të procesit mësimdhënies, gjë që nuk është aplikuar nga institucioni për këtë program.*

**Komenti i IAL:** Bazuar në dispozitat ligjore mbi arsimin e lartë, Kodin e Cilësisë është në autonomisë dhe lirinë e institucionit krijimi i strukturave përgjegjëse për cilësinë. Në këtë kuadër UMT-ja bazuar në Ligjin nr.80/2015, në Statutin e UMT, miratuar nga MASR, theksojmë se të gjitha nivelet e strukturave përbërëse të UMT janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë (RVB, standardi VI.4, paragrafi i parë), bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatorë të UMT, me synimin e gjithëpërfshirjes të kontribuesve në procesin e mësimdhënies dhe aspekteve të tjera akademike. Aktualisht struktura e NJSBC-s në UMT në bashkëpunim me njësite kryesore dhe njësitë bazë përgjegjëse për programin e studimit, monitorojnë në vijimësi programin e studimit, duke e konsideruar si një proces ciklik në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë *Vlerësojmë se standardi përmbushet plotësisht.*

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** bazuar në specifikën e këtij programi dhe një ecurie më të mirë të tij në të ardhmen, jo vetëm në rritje të numrit të studentëve por dhe në konsolidimin e vetë programit.

#### 16. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.5, kriteri 4

**Komenti në RVJ:** *Mendojmë që strukturat e vlerësimit të cilësisë dhe sidomos NJSBC duhet të adresojnë më drejtpërdrejt dhe më hollësisht problematikën e dalë. Nga ana tjetër, për vetë historikun e shkurtër të këtij programi dhe numrin e ulët të studentëve, edhe vlerësimet e të gjitha strukturave lidhur me vlerësimin do të konsideronim jo të plota në funksion të qëllimit të tyre.*

**Komenti i IAL:** Në vijim të argumentimeve të mësipërme, në vlerësimin tonë NJSBC ka adresuar saktë dhe drejtpërdrejtë çështje apo problematika të dala nga Raporte analitike të hartuara nga kjo njësi. Kryetari i NJSBC është Zv/rektor i UMT, i cili është njëkohësisht dhe anëtar i Senatit Akademik. Vetë pozicionimi në këtë nivel të lartë hierarkik në UMT, ka

mundësuar informimin në kohë reale të organeve drejtuese kolegjiale lidhur me çështjet e sigurimit të cilësisë, adresimin për zgjidhjen e problematikave të hasura etj.

**Argumentimi i GVJ:** GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi bazuar në specifikën e këtij programi dhe një ecurie më të mirë të tij në të ardhmen, adresimi i veçantë nga NJSBC-ja i problematikës në ecurinë e këtij programi do i shërbente edhe konsolidimit të vetë programit.

**Shënim:** Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme të pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të II-të Master i Shkencave (Msh) në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”, ofruar nga UMT/ Fakulteti i Ekonomisë, në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program relativisht specifik dhe bashkëkohor ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studenteve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti. <i>Aneks 1; Aneks 3</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në Strategjinë e UMT-së. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar në Statutin e Institucionit. Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit. <i>Aneks 1; Aneks 53</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UMT-së dhe Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e tij, të shprehura në strategjinë e zhvillimit të institucionit me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike praktike në fushën e aplikimit të programeve inxhinierike dhe informatike në përgjithësi dhe të menaxhimit të riskut financiar në veçanti. Në zbatim të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë bazë të këtij programi, Departamentit Financë-Bankë, si pjesë e

	Fakultetit të Ekonomisë të UMT-së. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me aplikimin e programeve informatike bashkëkohore në fushën e financës. <i>Aneks 1; Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi ofron mundësi për të plotësuar tregun e punës në fushën e aplikimit të programeve inxhinerike dhe informatike në fushën e financës dhe sidomos të menaxhimit të riskut në sektorin financiar publik dhe veçanërisht atë privat në nivel kombëtar, por para së gjithash në atë lokal. Vetë niveli i lartë i programit në inxhinieri financiare dhe menaxhim risku bën të mundur koordinimin e nivelit shkencor me atë aplikativ në shërbim të sektorit financiar. <i>Aneks 1; Aneks 3; Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55; Aneks 58</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Bazuar në përmbajtjen e programit, syllabuset dhe strukturën e tij evidentojmë para së gjithash përmbushjen e standardit shkencor përnjë program të nivelit të dytë. Niveli dhe struktura e tij është e përshtatshme dhe përligj plotësisht përmbajtjen shkencore të programit ku dominojnë transmetimi i njohurive shkencore në fushën e informatikës inxhinerike dhe financës, të gërshtuar me ato aplikative dhe profesionale. Mbi këtë bazë programi përmbush kriteret për të mundësuar vazhdimin e programit të ciklit të tretë të studimit Doktoraturë në fushat që përfshin ky program. <i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55; Aneks 102</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” është hartuar në përputhje me Statutin e UMT dhe rregulloret përkatëse të këtij institucioni që janë miratuar nga instancat përkatëse vitin 2018 dhe që reflektojnë ndryshimet në funksion të ligjit aktual në fuqi të arsimit të lartë. Ky program, që e ka fillimin e tij në vitin akademik 2018-2019, reflekton synimin e institucionit dhe veçanërisht njësisë bazë të tij, Departamentit

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dritë Sallaku*

*ASCAL*

	<p>Financë-Bankë,për të zhvilluar këtë program unik në llojin e vet. Strategjia e institucionit është hartuar një vit më pas (2019) që mëshiron edhe objektivat e këtij programi.</p> <p><i>Aneks 1; Aneks 2</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti dhe rregullorja e UMT-së përcaktojnë shtyllat kryesore ku mbështetet gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit. Kjo rregullore është miratuar para zhvillimit të programit, në nëntor të vitit 2018, duke reflektuar edhe ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Krahas kësaj baze rregullative, edhe vetë njësia bazë, Departamenti Financë-Bankë që mbulon këtë program, ka rregulloren përkatëse ku janë të përcaktuara edhe drejtimit kryesore të këtij programi.</p> <p><i>Aneks 1; Aneks 2</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Ky program është në unison me fokusin dhe drejtimit kryesore akademike, shkencore dhe profesionale të Fakultetit të Ekonomisë dhe njësisë bazë të tij Departamentit Financë-Bankë, duke fokusuar problematikën e menaxhimit të riskut të gërshetuara me aplikimin e programeve inxhinierike financiare në sektorin privat dhe publik, një drejtim ky pothuajse i pa mbuluar nga shumica e IAL-ve në vendin tonë.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55; Aneks 57</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar dhe lokal të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, ky program studimi,nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e inxhinierisë financiare dhe menaxhimit të riskut me fokus kryesor sektorin financiar i shërben këtij zhvillimi. Kjo e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në fushën e Inxhinierisë Financiare që ende jo vetëm është e rëndësishme, por edhe nevojat e tregut për specialist me njohuri në këtë fushë janë në rritje. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e inxhinierisë financiare nëpërmjet programeve informatike bashkëkohore të kërkuara nga sektori financiar privat qe në trendin e zhvillimit të tij rrit kërkesën për përdorimin e njohurive të inxhinierisë financiare dhe menaxhimit të riskut.</p> <p><i>Aneks 3; Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”, ka të përcaktuara qartë objektivat e tij që përfshijnë nivelin e duhur shkencor dhe aspektin aplikativ e profesional që synon tu japë studentëve. E rëndësishme është të theksohet që përnatyrën e tij pothuajse unike, ky program arrin të harmonizojë aspektin shkencor me atë aplikativ dhe profesional për të diplomuarit në këtë program. Karakterin shkencor e shohim në përmbajtjen e disa lëndëve ku dominon ana teoriko-shkencore si “Metodologjia e kërkimit”, “Strategjia e Menaxhimit të Riskut”, “Modelingu financiar”, etj, ndërsa anën aplikative e përfshijnë lëndë të tilla si: “Aplikimi Matlab në Finance”, “Statistika financiare”, “Strukturë të dhënash dhe algoritmesh financiare”, etj. Këtojanë njohuri që kërkohen në tregun e punës me kërkesat bashkëkohore që tashmë ka sektori financiar dhe bankar.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55; Aneks 58</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore dhe Departamenti Financë-Bankë si njësi bazë e këtij programi, kanë realizuar një studim mbi tregun e punës lidhur me studentët që do të përfundojnë këtë program studimi. Nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, në studim u përfshinë dy grupe kryesore: drejtuesit e Fakultetit të Ekonomisë dhe studentë të vitit të tretë Bachelor. Në këtë kuadër u mor informacioni i dëshiruar lidhur me nevojat e tregut të punës për specialist financiar, kryesisht në sektorin privat, por edhe në atë publik. Studimi ka informacion të bollshëm dhe analiza të detajuara.</p> <p><i>Megjithatë, në pjesën me të madhe të tij, studimi është i përgjithshëm dhe mungojnë pjesërisht referencat e nevojave të tregut për specialistët që përfundojnë këtë program dhe që kanë veçori në kompetencat e tyre të cilat mund të ofrohen në vende specifike dhe delikate të sistemit financiar (të tilla si Drejtoritë/Departamentet e riskut pranë institucioneve financiare, Departamentet e informatikës ekonomike dhe inxhinierike, etj).</i></p> <p><i>Rekomandojmë që, për vetë specifikën dhe rëndësinë e këtij</i></p>

	<p><i>programi që është pothuajse unik, institucioni, të ndërmarrë studim të veçantë të tregut përtë diplomuarit e ardhshëm në këtë program. Kjo do të mundësojë jo vetëm njohjen e drejtpërdrejtë të tregut nga institucioni, por krijon dhe lidhjen e duhur me tregun e punës e cila mund të krijojë mundësinë e marrëveshjeve mes institucionit dhe punëdhënësve potencial për të diplomuarit në këtë program. Kjo i jep UMT jo vetëm një përparësi dhe reputacion, por edhe garanci për punësim të studentëve që mbarojnë këtë program.</i></p> <p><i>Aneks 23; Aneks 74; Aneks 82</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit, konstatohet që në tërësinë e vet ky program bazohet në objektiva formuese të qarta dhe strukturë të përshtatshme që janë në funksion të dijeve dhe aftësive të studentëve në tregun e punës. Ky program tashmë i përgatitur në kuadër të kërkesave ligjore dhe rregullative me kohëzgjatje 2 vite akademike, arrin të përgjigjet nevojave të tregut të punës sidomos në sektorin financiar privat dhe publik me specialistë që kanë njohuri të avancuara teoriko shkencore, por të integruara me programe inxhinierike informatike të aplikuar në kuadër të menaxhimit të riskut, duke përbërë një premisë për të pasur kërkesa të shumta nga ky treg. Vetëpërmbajtja e programit, që është pothuaj unik në atë çfarë specialistësh përgatit, përbën përparësi të institucionit që e ofron. Një përparësi tjetër që mendojmë është se ai është atraktiv jo vetëm për studentët që kanë mbaruar programin Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, por edhe për studentë që kanë mbaruar në fushën e inxhinierisë dhe matematikës që duan të specializohen në fushën e inxhinierisë financiare dhe menaxhimit të riskut.</p> <p><i>Duke parë më me detaje programin, vërejmë se në kuadër të hapësirës së lejuar për ndryshime në kurrikul në këtë fazë (deri 20%) mund të bëhen ndryshimet e mëposhtme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i>Për të qenë më fleksibël, mund të aplikohen disa lëndë me zgjedhje sidomos në semestrin e I-rë të vitit të dytë, duke rritur mundësinë që studentët të “profilizohen” në drejtime të caktuara, qoftë edhe në funksion të punimit të mikrotezës. Kështu, lëndët “Mikrofinanca” dhe “Etika dhe standardet profesionale në financë”, të cilat janë të detyrueshme, mund të bëhen me zgjedhje, së bashku me lëndë të tjera të fushës së financës;</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i>Meqenëse ky program është atraktiv edhe për studentë që kanë mbaruar studime joekonomike (inxhinieri, matematikë, etj) për këta studentë mund të shtoheshin lëndë bazike të fushës së ekonomisë apo financës, duke u mundësuar atyre të përvetësojnë më lehtë dhe plotësisht lëndë të financës, që kanë njohuri të avancuara dhe që kërkojnë baza teorike të marra më parë;</i></li> <li>➤ <i>Mund të rregullohet rradha e zhvillimit të lëndëve të veçanta. Kështu, lënda “Menaxhim i Riskut dhe vlerësimi” që zhvillohet në semestrin e dytë të kursit të I-rë, mund të ndërrojë vendin me lëndën “Strategjia e Menaxhimit të Riskut”, që logjikisht zhvillohet e dyta. Gjithashtu, lënda “Statistikë financiare” mund të zhvillohet përpara se të zhvillohet lënda “Strukturë të dhënash dhe algoritmesh financiare”, duke ruajtur logjikën e marrjes së njohurive.</i></li> </ul> <p><i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55; Aneks 58</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i këtij programi studimi mendojmë se ai përafrohet me programe të ngjashme studimi në Universitete homologe të vendeve të tjera që fokusohen në fushën e inxhinierisë financiare dhe menaxhimit të riskut. Nga vizita në institucion, morëm informacion për referencën e përgatitjes së këtij programi me universitete të huaja që ofronin programe në këtë fushë dhe që UMT ka marrëveshje, si psh. Universitetin Politeknik në Ankona dhe Universita degli Studi di Messina.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55; Aneks 58</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikrat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi. Hartimi është fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, në zhvillimin e tij kryesisht me staf efektiv dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha ndryshimet në të. Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” në variantet me 120 ECTS, në përputhje me standardet dhe praktikrat më të mira bashkëkohore.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 55; Aneks 58</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e inxhinierisë financiare dhe atë menaxhimit të riskut, duke synuar që të rrisë edhe aftësitë praktike që përfshijnë fushën e mësipërme.</p> <p>Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në</p>

<p>ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>praktikën profesionale 3 mujore të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin që mbulon këtë program, u theksua rëndësia që i jepet gjatë zhvillimit të shumicës së lëndëve karakteri aplikativ nëpërmjet programeve bashkëkohore dhe që janë tashmë prezentë në shumicën e institucioneve financiare në vend. Megjithë vështirësitë e krijuara gjatë semestrit të dytë të studentëve të kursit të II-të për shkak të pandemisë, për realizimin e punimit të mikrotezës studentët ishin orientuar drejt trajtimeve aplikative. Këtë e konfirmuam gjatë takimit me studentët që janë në prag të mbrojtjes së punimit. Nga verifikimi ynë, praktika profesionale realizohet kryesisht pranë institucioneve financiare apo kompanive në degët e financës së tyre.</p> <p>Bazuar në emërtimin e programit, ky program është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i programit është në përputhje me drejtimin e tij në Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku në sektorin financiar.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 66; Aneks 124</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program zotëron gjuhë të huaja të vendeve të BE dhe mund të zhvillojë leksione në këto gjuhë. Nga vizita pranë institucionit, takimin me stafin që mbulon programin si dhe shqyrtimi i CV të stafit, evidentuam që dy lëndë të programit jepen në anglisht, nga pedagogë që kanë mbaruar jashtë vendit. Nisur nga fakti që kemi të bëjmë me një program MSH që është i detyrueshëm zotërimi i gjuhës së huaj për studentët, kjo nuk përben pengesë por përparësi. Gjithashtu, në këto lëndë, por jo vetëm, literaturë rekomanduese jepet në anglisht. Megjithëse programi ka dy vite që ka filluar, një student i kursit të dytë ka realizuar mobilitet në kuadër të Projektit ERASMUS një semestër pranë një universiteti të vendeve të BE (Rumani). Dhënia e lëndëve të veçanta në gjuhë të huaj, jep mundësinë në të ardhmen e realizimit të mobiliteteve nga studentët të universiteteve të huaja pranë institucionit në kuadër të programeve të ndryshme ERASMUS, etj.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 56</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e</p>	<p>Pranë institucionit ruhen dhe arkivohen në gjuhën angleze një pjesë e dokumentacionit të lidhur me programin si: programi i studimit, syllabuset, CV e personelit, marrëveshjet e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Divina Salha*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*ASCAL*

zhvilluar edhe në gjuhën angleze	bashkëpunimit, rregullore të brendshme, etj. Ky informacion ruhet në formë elektronike dhe hardcopy. Ruajtja e dokumentacionit respekton dhe konfidencialitetin e tyre, që është sanksionuar në rregulloret e institucionit. <i>Aneks 2; Aneks 50; Aneks 95; Aneks 114</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Organizimi i UMT, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”, duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet humane të përshtatshme për një mision të tillë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti Financë-Bankë që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Kështu, bazuar në organigramën e Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e programit, ai përfshin tre Departamente: Departamentin e Shkencave Administrative, Departamenti Financë-Bankë dhe Departamenti i Informatikës Ekonomike.</p> <p><i>Lidhur me përbërjen e Fakultetit dhe Departamentit, duhet të evidentohet fakti se ka mospërputhje në të dhënat e deklaruara nga IAL në RVB (psh. fq. 21-22), evidencën 66, 68, tabelën 1 dhe 2, për sa i përket numrit të stafit dhe kualifikimit të tyre. Për sa më lart, GVJ, në pasqyrimin e këtyre të dhënave, i është referuar tabelave 1 dhe 2.</i></p> <p>Referuar këtyre tabelave, Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga 24 staf akademik me kohë të plotë (prej të cilëve 19 me grada/tituj) dhe 45 staf akademik me kontratë (prej të cilëve 37 me grada/tituj).</p> <p><i>Tabela 1; Tabela 2</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është relativisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Divina Salke*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*AMU*



studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi që është Fakulteti i Ekonomisë si një ndër Fakultetet e UMT. <i>Ligji Nr. 80/2015; Aneks 1; Aneks 2; Aneks 95; Aneks 114</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi që është Departamenti Financë-Bankë që mbulon këtë program, i cili që në emërtim është i njëjtë me objektivin e këtij programi dhe që gjithashtu ka pjesën më të madhe të stafit të programit nga fusha e financës. <i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 58</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të këtij programi është Departamenti Financë-Bankë. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime periodike për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, etj. Ndër funksionet kryesore të Departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve) si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies. Përgjegjësitë e kësaj njësie bazë si dhe të hallkave të tjera të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Durrës*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Handwritten signature*

	<p>Fakultetit janë të mirë përcaktuara në rregulloren përkatëse të funksionimit të Departamentit dhe në rregulloren e Fakultetit. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. Vlerësimet e mësipërme u evidentuan edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Aneks 4; Aneks 56; Aneks 58</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UMT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe brenda vendit, si dhe me një numër subjektsh ekonomike private. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj. Gjatë vizitës në institucionu evidentua edhe përfshirja e lektorëve të huaj për të dhënë leksione për tema të veçanta, ku një temë specifike është trajtuar me studentët e këtij programi dhe të programeve të tjera në fushën e ekonomisë në Dhjetor 2019, me një profesor nga universiteti BUY –Idaho SHBA.</p> <p><i>Aneks 28; Aneks 72; Aneks 75</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UMT ka një sërë marrëveshesh me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Kështu, mund të përmendim Institucionin e sigurimeve SIGAL, MSA Construction, Albania Tax Consulting, Tirana International Hotel, etj. Përkëtë program është viti i parë që studentët kanë realizuar praktikën profesionale të mundësuar nga institucioni.</p> <p><i>Aneks 124</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në realizimin e praktikës profesionale hartohet kontratë e përbashkët mes UMT dhe entit përkatës në funksion, kjo edhe të natyrës së programit studimor. Uverifikua që institucioni ka të miratuar paketën e plotë të praktikës (vendim nr. 24 i Fakultetit të Ekonomisë) për vitin akademik 2019-2020, me të cilën janë pajisur studentët e këtij programi. Kjo u konfirmua dhe nga takimi me studentët. Paketa përfshin programin e praktikës, vlerësimin e</p>

	monitoruesit të saj, etj. <i>Aneks 124</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga IAL, janë të listuara rreth 37 marrëveshje në kuadër të programeve të Fakultetit të Ekonomisë, prej të cilave 5 janë marrëveshje me Universitete homologe jashtë vendit (si: Universita degli Studi di Messina, Universita Politecnica delle Marche, Ancona, etj.) që kanë krijuar mundësi shkëmbimi përvoja të stafit akademik tëUMT. <i>Megjithatë, mendojmë se duhet të rritet më tej numri i marrëveshjeve me Universitete homologe të huaja.</i> Ndërsa do ta konsideronim optimale numrin e marrëveshjeve me institucione apo aktorë të tjerë të tregut, që ndihmojnë në realizimin e praktikës profesionale, por edhe e kërkimit shkencor të studentëve. Nga takimi me studentët u evidentua angazhimi i tyre në kërkim shkencor lidhur me përgatitjen e punimit të mikrotezës. <i>Aneks 22; Aneks 23; Aneks 73; Aneks 75; Aneks 124</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	<i>Departamenti Financë-Bankë nuk harton raporte të veçanta lidhur me bashkëpunimin me entet e ndryshme.</i> GVJ shqyrtoi raportet periodike të analizës mësimore shkencore të Departamentit, ku në to përfshihet edhe analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me entet e ndryshme. <i>Aneks 73</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi I.6</b>	
<b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Si një institucion me një historik të programeve tëshkencave aplikative (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës) UMT synon të jetë aktiv në fushën e kërkimit shkencor të personelit akademik. Në webin e institucionit u evidentuan publikimet e bëra nga personeli akademik si dhe veprimtari të tjera lidhur me kërkimet shkencore. <i>Aneks 24; Aneks 36</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salke*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*AMU*

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni ka njësi të veçantë për kërkimin shkencor siç është Metro Research, inkubatori ku janë përfshirë krahas personelit akademik edhe studentë. Kjo qendër u vizitua edhe gjatë vizitës në Institucion dhe u mor informacion më i hollësishëm mbi aktivitetin e kësaj njësie, ku së fundmi ishin realizuar produktet e para të vlerësimit të sipërmarrjeve të suksesshme. Gjithashtu, ndjekja e procesit kërkimor shkencor bëhet nga Zv. Dekani për kërkimin shkencor; Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve që mbështet, inkurajon dhe evidenton punën kërkimore të stafit.</p> <p><i>Aneks 73; Aneks 93; Aneks 94</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Personeli akademik, krahas punës së pavarur kërkimore shkencore, promovohet nëpërmjet përfshirjes në projektet kërkimore të fituara nga institucioni dhe që implementohen nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projektet, duke bërë të mundur publikimin e tyre dhe në disa raste mbështetjen financiare. Punime shkencore të personelit akademik janë botuar në revistën shkencore të UMT (“Journal of Business and Economics” me Bord Shkencor dhe me indeks Copernicus) si dhe janë promovuar botime në revista të huaja me faktor impakti.</p> <p><i>Aneks 93; webi i UMT</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Kopje të punimeve shkencore janë të arkivuara në bibliotekën e UMT dhe në dosjet përkatëse të personelit, të cilat u panë në mënyrë të rastësishme edhe gjatë vizitës në institucion. Në botimet e publikuara në revistën e UMT theksohet pronësia intelektuale e tyre me qëllim minimizimin e plagjiaturave.</p> <p><i>Aneks 93</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Institucioni ka angazhuar studentë në projektet ku është partnere si dhe në ndihmë të kërkimeve shkencore që realizon personeli akademik sidomos në anketime dhe përpunim të dhënash. Shpesh kjo punë e tyre materializohet në punimin e diplomës apo mikrotezës. <i>Një gjë e tillë nuk evidentohet për studentët e këtij programi pasi ata janë në fazën e përgatitjes së punimit.</i></p> <p><i>Aneks 120</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>
--	-------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Divina Salha*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*ASCA*

standardeve të fushës I	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” që tashmë është në vitin e dytë akademik, është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë, me një total 120 kredite në dy vitet dhe me ngarkesë studenti 25 orë në javë.</p> <p><i>Duke shqyrtuar planin mësimor të këtij programi studimi, konstatohet që secila nga 15 lëndët e përfshira në program, është vlerësuar me 6 kredite. GVJ mendon që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperiencë të programeve në Universitete të tjera, numri i krediteve të përcaktuara, duhet të luhet në funksion të ngarkesës (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit. Në këtë gjykim, lëndë të caktuara karakterizuese mund të kenë një numër kreditesh me të lartë se të tjerat, kjo rrjedhje e vështirësive apo orëve të angazhimit jashtë auditorit, që për lëndë të ndryshme mund të jenë më shumë.</i></p> <p>Aneks54</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Duke shqyrtuar programin mësimor si dhe përmbajtjen e syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës, aplikimit kompjuterik të programeve financiare dhe inxhinerike. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë të riskut, specialistë të aplikimeve të programeve të informatikës në financë, analizë statistikore të treguesve financiare, etj.</p> <p>Aneks 53; Aneks 54</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit</p>	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dimitri Spalke*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*AMU*

<p>“Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>studimit. Nga shqyrtimi i syllabuseve vihet re që ka tema të cilat japin një trajtim të shpejtë të koncepteve të marra në programin Bachelor sipas fushës që mbulon lënda përkatëse. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës apo ekonomisë. Nga ana tjetër, lëndë të caktuara si “Modelingu financiar”, “Aplikim Matlab në Financë”, etj., japin mjaft trajtime të avancuara ku përfshihen ndërthurjet e njohurive të informatikës me ato të financës apo ekonomisë në tërësi.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ofron njohuri të avancuara në fushën teorike shkencore, por dhe të natyrës aplikative në fushën specifike të inxhinierisë financiare apo të menaxhimit të riskut. Këtij qëllimi i shërbejnë trajtimet specifike të programeve informatike të njohura në fushën e financës. E rëndësishme është që në këtë program arrihet të merren edhe njohuri mbi menaxhimin e riskut të institucioneve financiare, të cilat gërshetohen me njohuritë e inxhinierisë financiare që “specializojnë” në një farë mase të diplomuarit në këtë program.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i këtij programi studimi rezulton se ai përfshin të gjithë elementët strukturor të përcaktuara në aktet ligjore dhe rregullative që kanë objekt arsimin e lartë në Shqipëri, të tilla si numri i krediteve, kohëzgjatja e tij, sistemi i vlerësimit me kredite, kategorizimi i lëndëve, praktika profesionale, etj.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet me 120 ETCS (<i>ku përfshihen 15 lëndë, praktika profesionale dhe detyrimet përmblylëse</i>) dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike. Bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, sipas kategorizimit të lëndëve të paraqitura në programin e studimit rezulton se:</p> <p>Lëndët e kategorisë A zënë 10 % të numrit të krediteve; lëndët e kategorisë B zënë 50 %, kategoria C zë 15 %; kategoria D zë 10 % dhe kategoria E zë 15 %.</p> <p><i>Aneks 53</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën për përgatitjen e punimit të mikrotezës me 18 kredite me të cilën studenti përmblyl këtë program duke marrë diplomën “Master i Shkencave” në</p>

	<p>“Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”.</p> <p><i>Në modelin e diplomës të përcjellë në Dosjen e Vetëvlerësimit, ka një pasaktësi në emërtimin e programit, pasi është paraqitur vetëm “Inxhinieri Financiare”. Kjo gjë u diskutua edhe gjatë vizitës në institucion me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe u pranua prej tyre saktësimi në të ardhmen i këtij gabimi teknik. Për sa me lart, nevojitet që IAL të saktësojë modelin e diplomës përpara përcjelljes së saj për miratim në QSHA.</i></p> <p><i>Aneks 53; Aneks 58; Aneks 59; Aneks 60</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	UMT, në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave si Institucion i Arsimit të Lartë Jo Publik, është i organizuar dhe i përbërë me një strukturë hierarkike të tillë që të përmbushë dhe objektivat e programit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”. Fakulteti i Ekonomisë, si njësia kryesore (një nga 3 Fakultetet e Institucionit) dhe Departamenti Financë-Bankë si njësi bazë që mbulon zhvillimin e këtij programi, përmbushin kriteret ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. <i>Tabela 1; Tabela 2</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Ekonomisë, si njësia kryesore (një nga 3 Fakultetet e Institucionit) dhe Departamenti Financë-Bankë si njësi bazë që mbulon zhvillimin e këtij programi, përmbushin kriteret ligjore dhe aktet nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. <i>Tabela 1; Tabela 2</i>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Fakulteti i Ekonomisë, si njësia kryesore, aktualisht ka në përbërjen e tij 3 departamente dhe përbëhet nga 24 staf akademik me kohë të plotë (prej të cilëve 19 me grada/tituj) dhe 45 staf akademik me kontratë (prej të cilëve 37 me grada/tituj). Departamenti Financë-Bankë, si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, në <i>vitin akademik 19-20</i> , ka në total <b>26</b> staf akademik, prej të cilëve <b>8 PAE</b> , me kualifikimin: 2 Prof. As., 5

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Durrës*

*ASCA*

	<p>Dr., dhe 1 Dr., në proces., dhe <b>18 PAK</b>, me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 4 Prof. As., 8 Dr., dhe 5 Msc.(<i>tabela 1 dhe 2, viti akademik 19-20</i>).</p> <p>Në <i>vitin akademik 18-19</i>, Departamenti përbëhej nga <b>16</b> staf akademik, prej të cilëve <b>7 PAE</b>, me kualifikimin: 6 Dr., dhe 1 Dr. në proces, dhe <b>9 PAK</b>, me kualifikimin: 2 prof. Dr., 1 Prof. As., 5 Dr., dhe 1 Msc.(<i>tabela 1 dhe 2, viti akademik 18-19</i>).</p> <p><i>Sikurse përmendur edhe më lart, ka një mospërputhje në të dhënat e deklaruara nga UMT për përbërjen e fakultetit/departamentit në evidenca të ndryshme të tij, si RVB, evidenca 66, evidenca 68, tabelat 1 dhe 2. GVJ, në pasqyrimin e të dhënave, i është referuar tabelave 1 dhe 2.</i></p> <p><i>Tabela 1; Tabela 2 (viti akademik 18-19 dhe 19-20)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Financë-Bankë, me numrin aktual të personelit me kohë të plotë, plotëson detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën ligjore.</p> <p>Për vetë numrin e ulët të studentëve të këtij programi studimi (4 studentë janë në vitin e dytë) ndjekja e praktikës së tyre është bërë nga stafi akademik i programit. Në praktikën e deritanishme për studentët e programeve të tjera, krahas stafit akademik, caktohet edhe personel ndihmës në ndjekjen e praktikave të studentëve.</p> <p><i>Tabela 1; Tabela 2</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe rregullores së këtij programi janë të përcaktuara qartë gjithë problematikat lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor-shkencor të këtij programi, por nuk ka të theksuar caktimin e një personi përgjegjës në rolin e koordinatorit të programit. Nga vizita në institucion evidentuam që Përgjegjësi i Departamentit Financë-Bankë monitoron edhe këtë program duke qenë njëkohësisht edhe koordinatori i këtij programi, kjo me argumentin e rëndësisë që ka monitorimi i tij në këtë fazë kur numri i studentëve është minimal. Gjatë muajit të fundit, Departamenti, ka rritur intensitetin e punës lidhur me marketingun e këtij programi, me qëllim rritjen e numrit të studentëve që do të regjistroheshin këtë vit të ri akademik.</p> <p><i>Aneks 58; Aneks 81</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike të drejtuesi i njësies përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti Financë-Bankë dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit dhe jo vetëm si evidencë, por dhe të bërë publike në website e UMT. <i>Aneks41; Aneks 50; Aneks 53; Aneks 54; Aneks 56</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. i ndryshuar. <i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 56</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi përfshin një numër total prej 120 ECTS dhe është i ndarë në strukturë në orë në auditor, orë në aktivitete të tjera si projekte, orë studimi individual, elementë këto matës të sistemit ECTS. Ngarkesa mësimore prej 1800 orësh është e ndarë në mënyrë të barabartë në katër semestrat e vitit akademik. <i>Sikurse përmendur edhe më sipër, këto elementë të ngarkesës janë të njëjtë për çdo lëndë, gjë që mund të mos ketë marrë në vlerësim lëndë të cilat mund të kërkojnë më shumë angazhim se të tjerat. Mendojmë që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve, për lëndet e veçanta si dhe në mjaft eksperiencë të programeve në universitete të tjera, numri i krediteve të përcaktuara për lëndë të caktuara që janë 6 kredite, të mund të ulet në 3 apo 4 kredite, dhe për lëndë karakterizuese si “Inxhinieria Financiare” apo “Modelingu Financiar” të rritet. Kjo, rrjedhë e vështirësive apo orëve të angazhimit jashtë auditorit që për lëndët e propozuara mund të jenë më shumë.</i> Sugjerimet e mësipërme të GVJ mbi ndryshimet në numër kreditesh për lëndë të veçanta në këtë program i shërbejnë përmirësimit të tij në procesin e vlerësimit të programit dhe lirisë akademike.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dritë Sallku*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*ASCAL*

	<i>Aneks 53; Aneks 54; Aneks 56</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<p>Studentët, në fillim të secilit semestër, informohen gjerësisht dhe pajisen me programin e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar, etj.</p> <p>Ky informacion tashmë është edhe elektronikisht, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p> <p><i>Aneks 36; Aneks 37; Aneks 53</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Studentët kandidatë për tu regjistruar në këtë program si dhe ata që vazhdojnë procesin mësimor marrin informacion mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullores së studimeve të UMT</li> <li>• Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë</li> <li>• Rregullores së programit MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”.</li> </ul> <p><i>Mendojmë se, në kuadër të mundësive të rritjes së regjistrimeve të reja në këtë program, institucioni duhet të japë informacion edhe drejtpërdrejtë në takime me të diplomuarit në sistemin Bachelor, jo vetëm në fushën e Ekonomisë, por edhe ata që janë diplomuar në shkencat ekzakte inxhinerike dhe informatike që kanë një treg punësimi pothuajse të sigurt me përfundimin e këtij programi.</i></p> <p>Ky rekomandim ka si qëllim rritjen e prurjeve të reja me një marketing më intensiv, por që do ketë efekt më të lartë nëse programi është i akredituar.</p> <p><i>Aneks 2; Aneks 50; Aneks 58</i></p>
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit MSH. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërtimi i lëndës/modulit</li> <li>• Viti/semestri kur zhvillohet lënda</li> <li>• Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën</li> <li>• Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit</li> <li>• Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës</li> <li>• Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik</li> <li>• Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS</li> <li>• Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre</li> <li>• Format e vlerësimit të studentëve</li> <li>• Detyrimet e studentit për lëndën</li> <li>• Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse</li> </ul> <p>GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuara në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatësisht, studenti vlerësohet, 20% nga detyra e kursit; 30% nga provimi i ndërmjetëm; 50% në provimin përfundimtar. <i>Aneks 56; Aneks 56.1; Aneks 56.2</i></p>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Gjatë dy viteve akademike që ky program studimi po zhvillohet, nuk ka pasur ndryshime në program.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i	Ky program studimi plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore në

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	fuqi. Ai realizohet me një ngarkesë mësimore, shkencore dhe praktike me 120 ECTS dhe me afat kohor dy vite akademike. <i>Aneks53; Aneks 54</i>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi në përmbajtjen e tij ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e Inxhinierisë Financiare dhe Menaxhimit të Riskut. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në këtë treg specifik të punës kryesisht të sektorit financiar e bankar. <i>Aneks 53; Minutat e vizitës në UMT; Aneksset shtesë</i>
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e Inxhinierisë financiare dhe menaxhimit të riskut me fokus sektorin publik financiar. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e programimit financiar. Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve. <i>Aneks 56; Minutat e vizitës në UMT; Aneksset shtesë</i>
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punëspërkëto dy specialitete (inxhinieria financiare dhe menaxhimi i riskut). Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me profilin e zgjedhur që është inxhinieria financiare në sektorin financiar e bankar. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. <i>Aneks 53; Aneksset shtesë</i>
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas	Ky program arrin t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>teorike dhe aplikative. Bazuar në misionin dhe objektivat e tij, programi synon para së gjithash aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor. Nga takimi me stafin e programit dhe studentët gjatë vizitës në institucion, u evidentua rritja e angazhimit të pedagogëve (si rrjedhojë e kërkesave të studentëve) në trajtimet aplikative në laborator, sidomos për programet informatike.</p> <p><i>Aneks 53; Aneksët shtesë</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabusët (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Për vetë periudhën e shkurtër dy vjeçare që ky program studimi është aktiv, nuk evidentohet ndonjë përditësim lidhur me përmbajtjen e syllabuseve.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi Msc. në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” i pajis studentët që zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhimit të riskut si dhe të aplikimeve të modeleve dhe programeve të informatikës në fushën e financës. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet në inxhinieri apo matematikë, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të inxhinierisë financiare në sektorin financiar, kryesisht privat, duke u dhënë më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin privat.</p> <p><i>Për të realizuar këtë objektiv të fundit, rekomandohet futja në program për këtë kontingjent studentësh i lëndëve bazë në financë, mikroekonomi, kontabilitet, etj.</i></p> <p>Për një efikasitet më të mirë për studentët e ardhur nga shkencat inxhinierike, rekomandohet marrja e njohurive shtesë me lëndë bazike të financës mikro dhe makroekonomisë.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmërinë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve në segmentin e sektorit financiar e bankar.</p> <p><i>Aneks 53; Aneks 54</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen</p>	<p>Për vetë periudhën e shkurtër dy vjeçare që ky program studimi është aktiv, nuk evidentohet ndonjë përditësim lidhur me përmbajtjen e syllabuseve.</p>

dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.				
<b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Programi është një bazë e mirë lidhur me mundësinë në të ardhmen për studentët e diplomuar për të pasur mundësinë e fillimit të programit të ciklit të tretë të studimit (Doktoraturë) pasi ky program u jep mundësinë e përdorimit të aparatit matematikor, statistikor dhe informatikë në realizimin e një metodologjie bashkëkohore për punime të doktoraturës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Ky program studimi me 120 kredite, për vitin akademik <b>2019-2020</b> , mbulohet nga një staf prej <b>16 pedagogësh</b> , prej të cilëve <b>8 PAE</b> , me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 5 Dr., dhe 1 Msc. dhe <b>8 PAK</b> , me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 4 Dr., dhe 2 Msc.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Për vitin akademik <b>2018-2019</b> , programi është mbuluar nga një staf akademik prej <b>7 pedagogësh</b> , prej të cilëve <b>3 PAE</b> , me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Dr., dhe 1 Dr. në proces, dhe <b>4 PAK</b> , me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., dhe 2 Dr. <i>Të gjitha leksionet e programit zhvillohen nga personel me tituj akademik apo grada shkencore. Vetëm në 2 lëndë seancat e ushtrimeve zhvillohen nga staf me Msc., e përligjur kjo sipas IAL me aspektin teknik në këto lëndë.</i> Në vitin akademik aktual <b>19-20</b> , pesha e ngarkesës në auditor të realizuar nga <b>PAK</b> në këtë program është 300 orë nga 1200 orë ngarkese të programit (përfshirë këtu orët e praktikës profesionale dhe të punimit të mikrotezës) ose thënë ndryshe <b>25 % të ngarkesës totale</b> dhe pjesa tjetër, <b>75 % e ngarkesës</b> , mbulohet nga <b>PAE</b> . <i>Pra, si rrjedhojë konstatohet përmbushja e kriterit ligjor ku stafi PAE duhet të mbulojë jo më pak se 70 % të ngarkesës totale të</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dr. Miri Sallha*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Mirë*

	<p><i>programit.</i></p> <p>Në vitin akademik <b>18-19</b>, sikurse deklaruar edhe nga vetë IAL në tabelën 12.2, stafi akademik <b>PAE</b> ka mbuluar <b>60 % të ngarkesës</b> totale të programit të studimit dhe stafi akademik <b>PAK</b> ka mbuluar <b>40 % të ngarkesës</b> totale të programit. <i>Sikurse vërehet, në këtë vit akademik, nuk është plotësuar kriteri ligjor për mbulimin e ngarkesës nga staf PAE në masën të paktën 70 %.</i> Theksojmë se ky ka qenë viti i parë i funksionimit të programit të studimit.</p> <p>Ngarkesa totale e stafit të programit, në nivel IAL, varion nga 90 orë ngarkesë minimale, në 390 orë ngarkesë maksimale.</p> <p><i>Nisur nga treguesi i ngarkesës mësimore të stafit PAE, pedagogë të caktuar mbulojnë nga 3 deri në 5 lëndë. Nisur nga sa më sipër, do të ishte në interes të rritjes së nivelit të cilësisë së mësimdhënies, rritja e numrit të stafit me kohë të plotë nëpërmjet rekrutimeve të reja, me qëllim mbulim optimal të numrit të lëndëve nga pedagogët.</i></p> <p><i>Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se disa titullarë të lëndëve në këtë program janë personel me gradë shkencore Doktor. Institucioni duhet të angazhojë staf akademik të kategorisë “Profesor”, sikurse kërkuar nga legjislacioni në fuqi. Aneks 51; Aneks 56.1; Aneks 61; Tabela 12; Aneksët shtesë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar në përputhje me objektin apo fokusin e modulit/lëndës që zhvillon në program. Kualifikimet e stafit dhe eksperiencia e tyre përputhen me profilin e programit.</p> <p><i>Aneks 56; Aneks 56.1</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik që mbulon këtë program është angazhuar në ndjekjen e procesit të praktikës profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve. Nga vizita në institucion, ne takimin me stafin që mbulon këtë program, GVJ evidentoi që anëtarë të stafit janë caktuar për të ndjekur si praktikën e studentëve të këtij viti akademik që tashmë e kishin përfunduar, ashtu edhe si drejtues për punimin e mikrotezës. Theksojmë se numri i studentëve të kursit të dytë është 9 studentë, numër ky mjaft i ulët.</p> <p><i>Aneks 91</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>UMT dhe njësia kryesore, Fakulteti i Ekonomisë, ofron personel ndihmës mësimor shkencor për realizimin e orëve laboratorike apo shërbime të tjera në funksion të procesit mësimor. Për vetë specifikën e këtij programi orët në laborator zhvillohen nga pedagogu përkatës, ndërsa personeli ndihmës orienton studentët lidhur me anën teknike të përdorimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve. <i>Aneks 79; Aneks 107</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>X</b></p>				

<p><b>Standardi II.6</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Krahas studimit të tregut të punës të vlerësuar më lart, nga vizita në institucion u konstatua që janë bërë përpjekje për të realizuar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës që të mundësojnë studentët që do të diplomohen në këtë program. Deri tani janë bërë takime të drejtuesve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit Financë-Bankë me disa banka tregtare dhe kompani të mëdha dhe shpresohet të finalizohen marrëveshje mes dy palëve. <i>GVI sugjeron që marrëveshjet me këto institucione, sidomos me bankat dhe kompanitë e sigurimeve, duhet të specifikojnë sektorin apo drejtoritë e riskut dhe modelimeve, vende këto që justifikojnë njohuritë e marra në këtë program dhe pse jo, në to të kishite edhe angazhim konkret në procesin e mësimdhënies nga këto institucione.</i> <i>Aneks 22</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, u evidentua përfshirja e studentëve në përmirësimet në programin përkatës. Studentët e këtij programi kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me procesin e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve, të shpërndara për ta në fund të semestrit përkatës nga Departamenti Financë-Bankë, si dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Drini Salko*



	<i>Aneks 10</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Në këtë program studimi nuk ka ende studentë të diplomuar.			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Për vetë historikun e këtij programi studimi nuk ka pasur bashkëpunim të tillë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat kryesore të tij në funksion edhe të kërkimit shkencor nëpërmjet marrjes së njohurive të thelluara dhe të avancuara në fushën e inxhinierisë financiare dhe menaxhimit të riskut. <i>Aneks 53</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga takimi me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike. Bazuar në nivelin dhe nevojat e studentëve, pedagogë të caktuar kanë zhvilluar më shumë mësimet aplikative në laborator me qëllim plotësimin e kuadrit praktik të programit.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Për vetë specifikën e programit ai i nxit ata të angazhohen në projekte pasi një numër lëndësh ka karakter aplikativ dhe që bëhet e mundur me infrastrukturën që ofron institucioni. <i>Aneks 54; Tabela 9; Tabela 10</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Për vetë historikun e shkurtër të këtij programi nuk ka pasur fokusim në hartimin e politikave të tilla.
<b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe	UMT mbështet punën kërkimore të stafit të departamentit Financë-Bankë si njësi që mbulon këtë program. Kjo është realizuar nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të projektit

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dr. Miri Sallha*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Mirë*

administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	ERASMUS, mbështetja me botime në revistën e Fakultetit dhe angazhimi në projekte kërkimore që zhvillon UMT në fushën e ekonomisë (rasti i inkubatorit të përmendur më lart). <i>Aneks 97; Aneks 99</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita pranë institucionit, evidentohet se Institucioni është aktiv në realizimin e projekteve dhe iniciativave shkencore që materializohet me shumë të tilla të fituara në rolin e partnerit dhe në një rast të liderit të projektit. Aktualisht UMT ka në proces zhvillimi 6 projekte me një financim prej 350,000 EUR. Megjithëse ky është një program me histori të shkurtër, përmbajtja e tij bazuar në njohuri të thelluara shkencore është një premisë për tu përfshirë në projekte të fushës së ekonomisë dhe financës. <i>Aneks 75; Aneks 84; Aneks 93</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Zyra e marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve është aktive në përfshirjen e personelit akademik dhe studentët në realizimin e studimeve dhe analizave të ndryshme. Janë 6 projekte në proces implementimi ku janë përfshirë staf akademik dhe studentë. Nga ana tjetër, studentët realizojnë, sidomos gjatë periudhës së praktikës profesionale dhe përgatitjes së mikrotezës, analiza më të thelluara shkencore dhe aplikative. Në këto projekte është angazhuar një student nga ky program. <i>Numri i kufizuar i studentëve aktualë që janë në kursin e II-të, si dhe situata pandemike, e kufizojnë këtë angazhim nga ky program.</i> <i>Aneks 24</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Institucioni, gjatë viteve të fundit, ka qenë aktiv në organizimin e aktiviteteve promovuese, konferencave shkencore të organizuara në institucion ose jashtë tij, ku pjesëmarrja e studentëve ka qenë e kënaqshme. Bazuar në Raportin e aktivitetit kërkimor shkencor të UMT për periudhën 2017-2020 janë organizuar aktivitete shkencore të tilla si: 3 Konferenca Studentore, Simpoziumi

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Drini Salko*

	shkencor, Konkursi i inovacionit, si dhe tre botime në revistën shkencore të UMT. <i>Aneks 93; Tabela 19</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit në dosjen e vetëvlerësimit, nuk rezulton që të këtë udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënëse.</i> Vlen të theksohet që institucioni, në kushtet e zhvillimit online të mësimt të semestrit të dytë si rrjedhojë e situatës pandemike, ka nxjerrë udhëzues të veçantë për zhvillimin e mësimt. <i>Aneks 49</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Bazuar në organigramën e Institucionit si dhe në takimet e realizuara në Institucion, monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësisë mësimdhënëse të stafit akademik dhe ndihmës të programit realizohet në nivel institucional nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ndërsa në nivel të njësisë kryesore nga Fakulteti i Ekonomisë. Këto dy struktura përgjegjëse monitorojnë dhe vlerësojnë periodikisht mësimdhënien nëpërmjet performancës akademike që kryen Departamenti si dhe anketimeve me studentët e programit në fund të çdo semestri. Ky vlerësim paraqitet në formën e një raporti të veçantë dhe u paraqitet instancave përkatëse për analizë të mëtejshme dhe miratim. Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies e prezanton nëpërmjet raporteve

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Durrës*

*Handwritten signature*

	<p>periodike pranë instancave vendimmarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë Departamentit Financë-Bankë.</p> <p>Një mënyrë tjetër vlerësimi është edhe hartimi në fillim të vitit akademik i planit të punës për secilin pedagog, i cili monitorohet për zbatim nga drejtuesi i Fakultetit dhe Departamentit. Përmbushja e këtij plani pune është një nga vlerësimet e performances se pedagogut.</p> <p><i>Aneks 122</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UMT, nëpërmjet strukturave përkatëse, kryen periodikisht vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative nga ana e studentëve përmes metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Metoda të tërthorta: kryesisht në formën e anketimeve me studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Ky anketim zhvillohet dy herë në vit në fund të çdo semestri. Rezultatet e anketimit bëhen të ditura stafit nëpërmjet raportit të dalëpërkëtë qëllim, i cili analizohet në mbledhjen e Departamentit dhe qëshërben për të përmirësuar punën në të ardhmen. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të Institucionit, atyre të Fakulteteve dhe Departamenteve ku edhe analizohen si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</li> <li>• Metoda të drejtpërdrejta: përfshijnë vlerësimin me pikë për stafin në bazë të formularit të caktuar. Në skedën përkatëse të vlerësimit të pedagogut u evidentua një praktikë vlerësimi e materializuar në skedën përkatëse të vlerësimit të pedagogut.</li> </ul> <p><i>Aneks 122</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin e mësimdhënies, NJBSC dhe Departamenti Financë-Bankë përgatitin dhe shpërndajnë në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë e mësimdhënies, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese në nivel Fakulteti dhe Departamenti por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar.</p> <p>Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel departamenti, dekanati dhe rektorati bazuar në evidencën nr.11 e cila plotësohet nga studenti si vlerësim për pedagogun.</p> <p><i>Aneks 73</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe</p>	<p>NJBSC bazuar në rezultatet e anketimit dhe vlerësimin me pikë të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>procesit të mësimdhënies për çdo personel akademik mësimdhënës, harton një raport periodik vjetor të ecurisë së programeve të nivelit Master mbi problematikën e dalë. <i>Për këtë program nuk ka raport evidentues, kjo për vetë numrin e ulët të studentëve të tij, por Departamenti kishte rezultatet e realizuara me këta studentë.</i> Në funksion të kësaj problematike instancat drejtuese në qendër dhe ajo e njësisë bazë mësimore shkencore, parashirojnë masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e procesit dhe rritjen e cilësisë.</p> <p>Institucioni analizon mbi bazë Fakulteti dhe Departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë edhe opinionin e studentëve.</p> <p><i>Aneks 76</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi III.2</b> <b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia në programin MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminarë, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 15 lëndë, ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studentit testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me</p>

	<p>notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat janë të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 10 % frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit;</li> <li>• 30 % provim i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit;</li> <li>• 60% provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit.</li> </ul> <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p><i>Aneks 2; Aneks 50; Aneks 53; Aneks 54</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies (shih dhe vlerësimet më lart). Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysh në dy raste të kërkesave të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca seminare praktike në laborator duke rritur nivelin praktik të mësimnxënies nga studentët.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e Departamentit Financë-Bankë rezultojnë se UMT mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +.</p> <p>Bazuar në RVB, Institucioni ka organizuar trajnime të strukturuar në nivel universiteti dhe Fakulteti me ekspertë të fushës së pedagogjisë.</p> <p><i>Aneks25; RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizë duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e inxhinierisë financiare dhe menaxhimit të riskut. Kjo është arsyeja se një pjesë e stafit të këtij programi janë nga departamente të tjera të fushës informatike dhe inxhinierike.</p> <p><i>Aneks 56; Aneks 56.1</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në njësinë bazë. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve. Ky sugjerim theksonte përdorimin më të madh të rasteve studimore. E tillë konsiderohet rritja e orëve të aplikimit praktik në lëndët e modelimit dhe ekonometrisë, e evidentuar nga takimi me studentët.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Eksperiencia në mësimdhënie e stafit të programit bën që të përdoren format interaktive duke ndërthurur trajtimin teorik me atë aplikativ. Numri i vogël i studentëve në këtë program ka bërë që në të shumtën e rasteve studimore ato të përgatiteshin në grup (të gjithë studentët e regjistruar në kursin përkatës). Një zhvillim të mëtejshëm të këtyre metodave e përben dhe realizimi i mësimi online gjatë situatës pandemike. <i>Aneks 48; Aneks 102</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënive të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Vetë karakteri aplikativ i disa lëndëve, sidomos të modelimit dhe menaxhimit, rrisin pavarësinë e studentit në këtë proces.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.3</b> Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Ky programstudimi realizohet në një nga dy godinat e reja (godina nr.1 ku janë të akomoduar dhe zyrat e drejtuesve të UMT dhe njësisë kryesore, Fakulteti i Ekonomisë). GVJ vizitoi infrastrukturën e kësaj godine dhe konstatohet që në dispozicion të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<p>procesit mësimor janë 4 salla leksioni dhe 9 salla seminari si dhe dy laboratorë (lab. i informatikës dhe lab. multifunksional) të cilat disponojnë hapësira të mjaftueshme dhe cilësore për këtë qëllim.</p> <p><i>Aneks 107; Aneks 108</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambientet ku zhvillon mësimin ky program studimi janë funksionale dhe ofrojnë logjistikën e nevojshme në shërbim të procesit mësimor. Laboratori i informatikës ofron kapacitetin e nevojshëm për të realizuar nevojat e programit në shfrytëzimin e kësaj teknologjie. Për zhvillimin e mësimit pedagogët përdorin video projektorët të cilët së bashku me kompjuterin janë të instaluar në sallën e leksionit.</p> <p><i>Aneks 107; Aneks 108</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>UMT përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve me platformën përkatëse ku mundësohet informimi i integruar i informacionit student-pedagog. Nga takimi me studentët u evidentua përdorimi i kësaj platforme si dhe shfrytëzimi i rrjetit IT në ambientet e institucionit. Në këtë sistem studenti mund të regjistrohet në kursin përkatës, të marrë orarin mësimor, të kontrollojë vlerësimin, etj.</p> <p><i>Aneks43; Aneks 45</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Për realizimin e këtij programi institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse. Në përgjithësi tekstet bazë janë në gjuhë shqipe, përkthime të autorëve të huaj, si dhe botime të autorëve shqiptarë. Për disa nga lëndët karakterizuese të programit që nuk ka tekste të mirëfillta të studentëve në shqip, ofrohen krahas prezantimet në power point, por edhe leksione të parashtruara të pedagogut përkatës. Në dy lëndë të tilla ofrohet si literaturë bazë edhe material në gjuhë të huaj.</p> <p><i>GVJ mendon se në lëndë të caktuara të programit, kryesisht ato të karakterit aplikativ, mund të shtohet literatura e huaj, sidomos ajo në formën e manualeve dhe rasteve të studimit që i jep një karakter më praktik trajtimit të problematikës.</i></p> <p><i>Aneks 109</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë</p>	<p>Bazuar në vizitën që GVJ realizoi në bibliotekë rezultoi se ka literaturë relativisht të mjaftueshme, tekste mësimore në funksion të studentëve dhe stafit akademik. Në bibliotekën që ndodhet në godinën 1, na u ofrua lista e titujve të disponueshëm për pedagogët dhe studentët dhe seksioni në ndihmë të programeve të shkencave</p>



<p>procesit mësimor.</p>	<p>ekonomike. <i>Nga evidentimi ynë në ambientet e bibliotekës së UMT, rezulton që hapësira e leximit të saj është relativisht e vogël. Bazuar në listën e inventarit të librave në fushën e ekonomisë, biblioteka ofron një fond relativisht të mjaftueshëm librash në shqip dhe anglisht që janë në ndihmë të studentëve. Megjithatë, GVJ mendon që fondi i librave në dispozicion të studentëve duhet të ishte më i madh me tekste më specifike mbi inxhinierinë financiare dhe programeve bashkëkohore që përdoren sot në këtë sektor dhe menaxhim risku.. Duke u mbështetur në lëndët karakterizuese që zhvillohen në këtë program, rezulton se ka gjithmonë nevojë për shtimin e literaturës lidhur me këto lëndë të programit. Pavarësisht se titullarët e lëndëve e bazonin mësimdhënien në shumicën e lëndëve që zhvillohen në tekste të huaja të përkthyer ose të autorëve shqiptarë, numri i teksteve alternative të lëndëve duhet të jetë më i larmishëm si në titujt në anglisht ashtu edhe në shqip. Pasurimi i fondit të bibliotekës me tituj librash në shqip dhe anglisht do të pasuronte më tej fondin e bibliotekës dhe do u vinte në ndihmë studentëve.</i></p> <p>Biblioteka punon gjatë orarit 09:00 deri në 21:00. Orari është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës.</p> <p><i>Aneks 109</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë akses online në bibliotekën e institucionit duke shfrytëzuar literaturën e fushës përkatëse për tekste universitare, libra dhe artikuj shkencorë. Sektori i IT i universitetit mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në bibliotekë të dy sistemeve me fonde të hapura dhe fonde të mbyllura. Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u informua se shfrytëzimi i literaturës online bëhet deri tani me një adresë që është pa kosto, por po punohet për të pasur akses tjetër në këtë drejtim nëpërmjet platformave të njohura.</p> <p><i>Aneks 109</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizita në të dy laboratorët e përmendur me lart, bëhet i mundur realizimi i njohurive aplikative i lëndëve përkatëse si dhe i punimeve të detyrave të kursit apo diplomimit të tyre.</p> <p><i>Aneks 107</i></p>

<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor personeli akademik dhe studentët përdorin platformën online në hedhjen e materialeve mësimore dhe informimin e studentëve mbi procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pedagogë të caktuar përdorin platformat elektronike të komunikimit on-line në raste të caktuara për komunikim me studentët, siç janë: google classroom, zoom, etj. Evidentohet përdorimi i platformës “Gotoo meeting” krahas asaj të zakonshme “google classroom” në procesin e mësimdhënies gjatë situatës pandemike, që përkoi me semestrin e dytë. <i>Aneks 47; Aneks 48; Aneks 103</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët përdorin sistemin informatik që disponon institucioni edu4schools si dhe alternativat e tjera si GotoMeeting–GTM për informacion marrje materialesh mësimore studimore apo shkencore duke komunikuar kështu në kohe reale. <i>Aneks 47; Aneks 48; Aneks 103</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre që në fillim të periudhës përkatëse dhe gjatë përgatitjes së tyre. Uevidentua edhe në takimin me studentët që ishin në këtë fazë, orientimii studentëve nga pedagogët udhëheqës që ishin miratuar, si dhe procedurat e shkruara që orientonin studentët në këtë proces. <i>Aneks 64; Aneks 65</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

<p><b>Standardi III.4</b> <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në kuadër të plotësisht të kërkesave ligjore dhe nënligjore UMT ka ngritur Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) që është një strukturë në nivel institucional. Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit. NJBSC koordinon punën me njësinë bazë që është Departamenti Financë-Bankë që mbulon këtë program. Departamenti ka të caktuar një koordinator/mbikëqyrëse të programit që mban kontakte të vazhdueshme me NJBSC-në.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<i>Aneks 7; Aneks 10</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Fakulteti i Ekonomisë si njësia kryesore dhe Departamenti Financë-Bankësi njësia bazë ndjekin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nivelin e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së programit dhe cilësisë së tij e ka Departamenti i cili bën analiza periodike dhe raporton tek Dekanati i Ekonomisë dhe pranë NJBSC-së, e përcaktuar kjo edhe në planin e punës që hartojnë njësitë përkatëse për vitin akademik. <i>Aneks 50</i>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Departamenti Financë-Bankë si njësi bazë dhe monitoruese e programit, nxit zhvillimin e metodave të reja mësimdhënëse nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura me personalitete të njohura të fushës së financës apo zhvillimin e lëndëve apo pjesë të saj nga profesorë të ftuar. <i>Nuk u evidentua realizimi i këtyre metodave për studentët e këtij programi, por në kuadër institucional, UMT ka mbështetur zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</i> <i>Aneks72</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ evidentoi përpjekje të stafit të programit për të rritur kualifikimin e tyre dhe marrë eksperiencë të reja në procesin mësimor e shkencor. Kjo është realizuar nëpërmjet vizitave që anëtarë të stafit kanë realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit ERASMUS, pjesëmarrje të stafit në disa projekte kërkimore shkencore si dhe në prezantime të punimeve të tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Aneks 22; Aneks 24; Aneks 27</i>
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Anëtarë të stafit të këtij programi kanë marrë pjesë në projektin “SMART Marketing” që ndihmon në rritjen e kualifikimit të tyre me përdorimin e risive në fushën e teknologjisë digjitale. <i>Nuk u evidentua pjesëmarrje e pedagogëve, sidomos ata të rinj, në ndonjë seminar të organizuar mbi temën e aftësive pedagogjike.</i> <i>Aneks 22; Aneks 24</i>
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Nga takimi me stafin që mbulon këtë program u evidentua angazhim serioz i tij në zbatimin me përgjegjshmëri të realizimit të programit mësimor, duke i dhënë rendësi procesit të mësimnxënies nëpërmjet përdorimit të metodave aplikative sidomos në lëndët karakterizuese. Këtu ritheksojmë përdorimin e metodave aplikative

	bashkëkohore që përdoren nga institucionet financiare lidhur me menaxhimin e riskut.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Eksperiencia në mësimdhënie e numrit me të madh të personelit akademik që mbulon këtë program është një faktor i rëndësishëm për realizimin e procesit të mësimdhënies sa me bashkëkohor dhe të përmirësuar me arritjet në këtë drejtim. Marrja e eksperiencave nga stafi të metodave bashkëkohore të kolegeve të tyre pranë universiteteve të huaja është realizuar nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të projekteve ERASMUS ku institucioni është parter. <i>Aneks 93</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë për këtë program dhe vizitës në institucion, u evidentua fakti se institucioni ka miratuar një numër profesorësh të fushës akademike apo personalitete të njohura në organizatat publike dhe private, për të zhvilluar leksione të hapura për tema të veçanta dhe të trajtuara në mënyrë komplekse dhe inovative. <i>Aneks 93</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e UMT), njësisë kryesore (Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë) dhe rregulloren e këtij programi. Këto dokumenta janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuarat mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse. <i>Aneks 2; Aneks 56; Aneks 58</i>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te.</li> <li>• Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës</li> </ul>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Drini Salko*

	<p>nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre.</p> <p><i>Aneks 56; Aneks 58; Aneks 120</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësi profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduara dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që uevidentuan të përcaktuara në syllabuse.</p> <p><i>Aneks 120</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b> <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësi profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të parë të Kursit të II- të tëkëtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve vlerësohen me 40% të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra e kursit), ndërsa provimi përfundimtar zë 60 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij.</p> <p><i>Aneks 56; Aneks 63</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekreti dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Vitet e fundit UMT ka ndërrmarë iniciativë dhe ka aplikuar (<i>jo me studentët e këtij programi</i>) sistemin elektronik të testimit në disa lëndë dhe synon ta shtrijë gjerësisht në të ardhmen(<i>Projekti clean score</i>).</p> <p><i>Aneks 58; Aneks 63</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Drini Salko*

<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për realizimin e testeve dhe vlerësimin e dijeve të studentëve Departamenti Financë-Bankë, bazuar në rregulloret përkatëse, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është asistenti apo pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i Departamentit Financë-Bankë.</p> <p><i>Aneks 63</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga Departamenti Financë-Bankë. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste të caktuara (<i>kur grupi është i madh në numër, por jo në rastin e këtij programi</i>) shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit.</p> <p><i>Aneks 63</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi me 40% të pikëve të dijeve gjatë vitit jo vetëm i “mban të angazhuar” vazhdimisht studentët, por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj.</p> <p><i>Aneks 63</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë bazë, Departamenti Financë-Bankë monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim. <i>Institucioni nuk ka program antiplagjaturë që të evidentojë këtë mangësi për punimet e diplomave të studentit. Për të minimizuar këtë, nga takimi me stafin e departamentit, u evidentua rëndësia që i jepej punimit të diplomës, të bazuara në raste studimore. Kjo minimizon fenomenin e plagjiaturës. Kjo është e nevojshme tashme kur është kontingjenti i parë i studentëve që pritet të diplomohen këtë vit.</i></p> <p><i>Aneks 63; Aneks 64</i></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi me korrektësi i testimeve gjatë vitit akademik dhe në fund të tij është një garanci përvlerësimin e saktë të studentëve. Përgjigjet e testimit merren nga studentët brenda 2 ditëve nga zhvillimi i tij dhe ata kanë të drejtën e reklamimit të tij, siç edhe është parashikuar në rregulloren përkatëse.</p> <p><i>Aneks 63; Aneks 64</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ evidentoi faktin se përpara se pedagogu të dërgojë procesverbalin në sekretarinë mësimore lihet një ditë reklamimi për ta nëse ndonjë ka paqartësi apo pretendime mbi vlerësimin.</p> <p><i>Aneks 63; Aneks 120</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Praktikat e ankimimit të studentëve lidhur me vlerësimin kanë qenë të pakta në numër, ndërsa nuk ka pasur të tilla për studentët e këtij programi. Por, në rastet e evidentuara, Departamenti ngre komision vlerësimi të posaçëm dhe procesi dokumentohet deri në fund.</p> <p><i>Aneks 63; Aneks 120</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit. Nga shqyrtimi i syllabusve vihet re që ka një trajtim fillimisht të koncepteve në financë që janë marrë në programin Bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës apo ekonomisë.</p> <p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e inxhinierisë financiare dhe menaxhimit të riskut. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e aplikimeve të programeve në inxhinieri financiare dhe menaxhim risku, bankave, auditin apo financën.</p> <p>Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teoriko shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve.</p>

	<p>Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektivi dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>Mbështetur edhe nga interesat e studentëve që preferojnë të regjistrohen në këtë program por që vijnë nga programe të inxhinierisë apo matematikës, mendojmë se për këtë kontigjent studentësh të zhvillohen 2 deri 3 lëndë bazike në fushën e ekonomisë dhe financës, problematike që e kemi theksuar më lart në këtë raport.</i></p> <p><i>Aneks 54; Anekset shtesë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e inxhinierisë financiare me fokus menaxhimin e riskut për sektorin financiar. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në lëndët që bazohen në modelime dhe programe informatike të aplikuara në këtë fushë.</p> <p><i>Aneks 54; Anekset shtesë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedojë me pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (<i>bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Pedagogu i lëndës përkatëse, në fund të zhvillimit të mësimin, bën një përmbledhje të temave të trajtuara dhe orienton studentët lidhur me testin përfundimtar që do zhvillohet në sezonin e provimeve.</p> <p><i>Aneks 54; Anekset shtesë</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Anëtarë të stafit kanë marrë eksperiencë dhe njohuri bashkëkohore mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, kryesisht nëpërmjet angazhimit individual, vizitave në institucione universitare të huaja në kuadër të projekteve, apo gjatë angazhimit në projekte.</p> <p><i>Aneks 93</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit, konstatohet që anëtarë të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më e theksuar ka qenë në lëndët e “Modelingut Financiar”, “Aplikime matlab në Financë”, etj, lëndë këto që në aplikimin e tyre kërkojnë edhe një angazhim shtesë jashtë kornizës së syllabusit duke u zhvilluar në laborator.</p>



	<i>Aneks63; Aneks 99</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Stafi i programit diskuton gjatë zhvillimit të programit por sidomos në fund të tij çështje specifike që kryesisht kanë të bëjnë me aplikimin e njohurive të marra kryesisht në lëndët karakterizuese që lidhen me Inxhinierinë Financiare dhe menaxhimin e riskut. Kjo u evidentua në takimin me stafin që mbulon këtë program.			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Stafi i programit realizon një bashkëbisedim dhe komunikim të frytshëm me studentët për të marrë nga ata sugjerimet me qëllim rritjen e cilësisë mësimdhënëse. Një element i rëndësishëm në funksion të këtij qëllimi është edhe pyetësi që realizohet nga studentët në fund të semestrit ku në të ka rubrikë për këtë qëllim. <i>Aneks 11; Aneks 115</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundur angazhimin e tyre me studentët. <i>Nga ana tjetër GVJ nuk evidentoi që studentë të këtij programi të kishin marrë mbështetje financiare në këtë drejtim.</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve	Në rang institucioni GVJ evidenton forma bashkëpunimi mësimdhënieje me institucione homologe vendase por edhe ndërkombëtare. UMT ka mobilitete shkëmbimi me universitete të huaja. Mobilitetet e realizuara përfshijnë kryesisht shkëmbimet mes stafeve si dhe mobilitete studentësh që kanë studiuar për një periudhë afatshkurtër në universitetet e huaja partnere. <i>Nga studentët e këtij programi ne evidentuam realizimin vetëm të një mobiliteti të tillë, ndërsaj janë realizuar njënumër i konsiderueshëm mobilitetesh nga studentë të programeve të tjera.</i> <i>Aneks 23; Aneks 24; Aneks 65; Aneks 135</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës,	Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes së praktikës, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Divina Salha*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*ASCAL*

<p>para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>përmes një punimi Mikroteze. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e Institucionit dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë. Në këtë udhëzues jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të mikrotezës, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj. Studentët e kursit të II-të që takuam, ishin në fazën e përgatitjes përfundimtare të mikrotezës dhe mbrojtjen e saj para fillimit të vitit të ri akademik.</p> <p><i>Aneks 64; Aneks 65</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti Financë-Bankë, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes së diplomës me punimin e Mikrotezës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në Departamentin Financë-Bankë përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Aneks 64; Aneks 65</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjës të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të Mikrotezës bazohet në katër kritere kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësim gjatë vitit akademik;</li> <li>• Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit;</li> <li>• Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës;</li> <li>• Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti.</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të programeve të tjera që kanë përfunduar programi, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin.</p> <p><i>Aneks 64; Aneks 65</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, Departamenti Financë-Bankë miraton listën e pedagogëve</p>

tezës/diplomave.	<p>udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim.</p> <p><i>Aneks 64; Aneks 65; Aneks 91</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta.</p> <p><i>Aneks 64; Aneks 65; Aneks 91</i></p>
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<p>Nga takimi me studentët e Kursit të II-të të këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të mikrotezës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që ngafaza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruara. Në rastin e punimeve të Mikrotezës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zerë një peshë të konsiderueshme.</p> <p><i>Aneks 64</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	<p>Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në katër kriteret e përmendura më lart, bën vlerësimin e punimit të Mikrotezës me notë përfundimtare.</p> <p><i>Aneks 64</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në degë të tjera pasi kontingjenti i parë i studentëve që diplomohen, i përket vitit akademik 2019-2020, që ende nuk është përmbyllur. <i>Sikurse përmendur edhe më lart, në modelin e diplomës të përcjellë në Dosjen e Vetëvlerësimit, ka një pasaktësi në emërtimin e programit, pasi është paraqitur vetëm "Inxhinieri Financiare". Kjo gjë u diskutua edhe gjatë vizitës në institucion me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe u pranua prej tyre saktësimi në të ardhmen i këtij gabimi teknik.</i></p>

	<i>Aneks 19; Aneks 20; Aneks 46</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit të studimeve studenti pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit, diplomën dhe suplementin e saj. <i>Aneks 59; Aneks 60</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit. <i>Aneks 95; Aneks 114</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	UMT ka krijuar zyrë të veçantë të Burimeve Njerëzore e cila mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik.  Nga takimi me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në Fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë. Zyra ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcakton Departamenti përkatës, në vijim priten aplikimet, kontrollohen nga personeli përgjegjës dhe procedohen për intervistim. Zyra e BNJ është pjesë e të gjitha hallkave të procesit të rekrutimit dhe ndjekjes së progresit të stafit,

	<p>duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale.</p> <p>Nga shqyrtimi i dy dosjeve të rastësishme nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion. Nga përzgjedhja e dosjeve të stafit të programit gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, gjendet dokumentacioni si: kontrata e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV, etj.</p> <p>Po kështu, në dosjet e stafit akademik, ka edhe të dhëna lidhur me kualifikimet, pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore dhe akademike, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Aneks 2; Aneks 71</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Procedura e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës bazohet në Statutin /rregulloren e UMT dhe udhëzuesin “<i>Mbi politikat dhe procedurat e rekrutimit në UMT</i>”, ku janë të përcaktuar procedurat e rekrutimit të personelit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” është përzgjedhur mbi bazën e procedurave parashikuar nga kuadri rregullator i përmendur më lart, në reflektim të ligjit të ri për arsimin e lartë në RSH.</p> <p>Departamenti prezanton nevojat për staf akademik, mbi bazën e ngarkesës mësimore dhe numrin e studentëve të planifikuar, harton kriteret referuese dhe pasi miratohen nga Fakulteti, publikohen në faqen e internetit të institucionit dhe mediat audiovizive e të shkruara. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, Fakultetit, Departamentit dhe titullarit të lëndës që do japë mësim.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me procedurat e rekrutimit të personelit. Departamenti përcakton kriteret specifike dhe të përgjithshme për vlerësimin e kandidatëve për personel akademik. Shpallja e pozicioneve bëhet publike në faqen web të institucionit. Aplikimet kalojnë një sistem pikëzimi ku 70% zë përmbushja e dokumentacionit dhe 30% intervista.</p> <p><i>Aneks 2; Aneks 29</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Kriteret e shpallura për rekrutimet e reja të stafit akademik përcaktojnë kritere të përgjithshme dhe kritere specifike, ku këto të fundit përcaktohen nga Departamenti Financë-Bankë që është përgjegjës për këtë program studimi. Ndër kriteret specifike janë edhe njohja apo zhvillimi i lëndëve për të cilat do rekrutohet, bazuar në programin ku ato zhvillohen, apo preferencat për përfundim studimesh jashtë vendit.</p> <p><i>Aneks 2; Aneks 29</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Infrastruktura e UMT krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. UMT ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditorë. Nga verifikimi në institucion u evidentua realizimi i investimeve në përmirësimin e zyrave të personelit drejtues të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>Aneks107; Aneks 108</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka përdorur kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të një pjese të stafit, të siguruara më shumë në mënyrë individuale prej vetë stafit. Për këtë një pjesë e stafit që është i angazhuar në këtë program ka realizuar këmbime dhe vizita akademike në disa Universitete të huaja në kuadër të programit ERASMUS. Në rang institucional, apo edhe të njësisë kryesore (Fakultetit të Ekonomisë) janë organizuar leksione të hapura me lektorë apo personalitete të fushave që ndihmojnë aftësimin e stafit si dhe aktivitete shkencore të përbashkëta (simpoziumi shkencor i përmendur me lart). <i>Përveç kësaj, nuk janë përdorur forma të tjera për kualifikimin akademik dhe profesional të stafit, dhe veçanërisht në fushën e aftësimin pedagogjik dhe në atë të komunikimit në të</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dr. Miri Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Mirë*

	<p><i>cilat, sikurse u konstatua edhe nga takimi, rezulton se stafet kanë nevojë.</i></p> <p><i>Nuk na rezulton të jetë organizuar ndonjë trajnim specifik apo të parashikohet një organizim i një programi të caktuar në lidhje me kualifikimin e stafit në shkrim projektesh apo në avancimin e metodikave inovative të mësimdhënie, pedagogjisë etj.</i></p> <p><i>Aneks 48; Aneks 93; Aneks 100</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Institucioni, për të plotësuar kërkesat e programit në vitin e dytë të realizimit të këtij programi, ka angazhuar edhe staf akademik të jashtëm. Në vitin e dytë të aktivizimit të këtij programi, është arritur zbatimi i kriterit të mbulimit të mësimdhënies në masën të paktën 70% nga PAE. Konkretisht në këtë vit akademik është 72 %.. Për sa i përket angazhimit optimal, nga evidencat e dorëzuara pas vizitës, rezulton se ngarkesa minimale e stafit të programit në nivel institucional është 60 orë dhe ajo maksimale 390 orë. <i>Përsa i përket vitit të parë të aktivizimit të këtij programi studimi, 18-19, ngarkesa e mbuluar nga stafi PAE ka qenë 60 %, jo në përputhje me kërkesat e ligjit.</i></p> <p>Departamenti bën përpjekje për të angazhuar si staf akademik edhe personel të ftuar në përputhje me kualifikimet specifike dhe karakteristikat e karakterit ndërdisiplinor të programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 48; Aneks 54; Aneks 55</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi IV.3</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit</p>	<p>Referuar dokumentacionit të përcjellë dhe vizitës në institucion për infrastrukturën e UMT, GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare, pranë godinave 1 dhe 2, të përshtatshme për realizimin me sukses të programit. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerëzore, Financa, Biblioteka, etj. janë të akomoduar në ambientet e tyre</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

*Drini Salko*

dhe moduleve përkatëse.	përkatëse, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre.  <i>Aneks107; Tabela 16</i>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti Financë-Bankë kanë ambientet e mjaftueshme në dispozicion për të realizuar me performancë të mirë këtë program.  Fakulteti i Ekonomisë ofron ambiente që plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m <sup>2</sup> / student.  Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit.  <i>Aneks 107; Tabela 16</i>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Ne funksion të mësimin dhe punëve shkencore në godinën nr.1 të Fakultetit të Ekonomisë janë në shërbim të studentëve dhe stafit 2 laboratorë; një i informatikës dhe tjetri laborator multifunksional, që janë të pajisur me teknologjinë bashkëkohore. Këta laboratorë u shërbejnë edhe përgatitjes së punimeve të kursit apo mikrotezës, duke iu përshtatur dhe orarit të mësimin të MSH që është pasdite.  <i>Aneks 107; Tabela 16</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Programet e instaluar në kompjuterët e laboratorit janë bashkëkohore dhe në to janë instaluar edhe programe të lidhura me lëndë karakterizuese të këtij programi siç është aplikimi Matlab në Financë.  <i>Aneks 107; Tabela 16</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të	Me kapacitetet infrastrukture në dispozicion, institucioni garanton mbarëvajtjen e mësimin dhe kërkimit shkencor të programit.  <i>Aneks 107; Tabela 16</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Drini Salko*



tjera praktike				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentacion dhe vizitën në institucion, u konstatua se në dispozicion të studentëve vihet edhe Biblioteka, e vendosur në godinën nr 1. të Fakultetit të Ekonomisë. Në mjediset e kësaj Biblioteke studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. Orari dhe shërbimi i ofruar është në funksion të nevojave të studentëve. Mjediset e Bibliotekave janë të hapura edhe në fundjavë. Kjo bibliotekë ofron mundësinë e kërkimit dhe gjetjes së librave online në sallën e leximit në kompjuterin e vendosur përkëtë qëllim. <i>Megjithatë, mendojmë se hapësira e këtij mjedisi është jo optimale në funksion të qëllimit të saj.</i></p> <p><i>Aneks 109</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është përgjithësisht e pajisur me literaturë fizike në shqip dhe anglisht, edhe pse nga kontrolli rastësor për një literaturë të detyrueshme në gjuhë të huaj fondi i librave duhet konsideruar relativisht i plotë. <i>Në fushën e ekonomisë, bazuar në relacionin e bibliotekës, janë rreth 21 tituj tekstesh të huaj, por vetëm 2 janë më pranë literaturës së huaj që i takon këtij programi.</i></p> <p><i>Ka libra në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj megjithatë, u konstatua se për disa fusha, mungonte literatura dhe në disa libra, tekste universitare, numri i ekzemplarëve ishte shumë i limituar, pa harruar që në ndonjë disiplinë mungonin ekzemplarët. Rekomandojmë shtimin e fondit të librave me tekste në shqip por edhe në anglisht për lëndet karakterizuese të programit, me qëllim që leksionet e parashkruar që janë përgatitur nga stafi të plotësohen me këto tekste.</i></p> <p><i>Aneks 109</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Durrës*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*ASCA*

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Shërbimet aktuale që ofron biblioteka u ofrojnë akses të barabartë përdoruesve potencial (studentëve dhe stafit akademik) dhe pa kosto. Siç e kemi përmendur më lart, deri tani institucioni ka përdorur bibliotekën online të Mc Grew Hill, por së fundmi, po bën përpjekjet për një adresë tjetër me pagesë tarife (Takimet me drejtuesit në institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Ekziston një program kompjuterik i përdorur nga Biblioteka për gjetjen e titujve të librave. Po ashtu kompjuterët e gjetur në Bibliotekë mund të shfrytëzohen nga studentët pa kufizime. Studentet kanë akses të plotë për të siguruar botime online edhe nëpërmjet disa adresave që janë funksionale përbibliotekën elektronike.  Aneks 109</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Për vetë historikun e shkurtër të këtij programi si dhe të mangësive në fondin e librave specifik për të, institucioni planifikon të pasurojë këtë fond në të ardhmen e afërt.  Aneks 109; Takimi me drejtuesit e Fakultetit</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka ka orarin 9.00 me 21.00 duke ofruar shërbime edhe për studentet e këtij programi që e zhvillojnë mësimin pasdite.  Aneks 109</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron</p>	<p>UMT disponon prej platformën digjitale edu4schols, nëpërmjet së cilës menaxhohen aspekte të ndryshme të mësimdhënies dhe testimit të njohurive, por module specifike përdoren për të mbështetur metodat inovative të mësimdhënies si krijimi i klasave virtuale, shkëmbimi i materialeve me studentët, ndërveprimi dhe komunikimi me studentët, etj. Kjo platformë është një sistem i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dr. V. S. S. S.*

*[Signature]*

<p>informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi, jeta universitare, e deri në mbrojtjen e diplomës. Në të janë të përfshira module që mundësojnë menaxhimin e procesit mësimor, zhvillimin, planifikimin dhe menaxhimin e llojeve të aktiviteteve të ndryshme, etj.</p> <p>Gjithashtu:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucioni është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) ku me anë të moduleve të sistemit bazë të të dhënave, realizon procesin e aplikimit on line të kandidatëve për regjistrim në programet e UMT;</li> <li>• UMT përdor shërbimin e ASCAL-it nëpërmjet AMS për menaxhimin e informacionit elektronik;</li> <li>• Institucioni nëpërmjet faqes së tij zyrtare pasqyron informacionin me karakter akademik, administrativ kulturor e social.</li> </ul> <p>Informacioni shkencor realizohet edhe nëpërmjet revistës shkencore.</p> <p>Rrjetet sociale të njohura tashmë në tregun e informacionit janë mjete të tjera në funksion të marrjes dhe dhënies së informacionit që mbështetet me infrastrukturën e duhur.</p> <p>Sistemet e përmendura me lart mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit mes personelit akademik dhe ndihmës me studentët.</p> <p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe administrativ të këtij programi bëhet nga Departamenti Financë-Bankë. Me këtë rol merret kryesisht përgjegjësi i Departamentit dhe drejtuesit e grupeve mësimore dhe kërkimore. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimin, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në Fakultet. Gjithashtu sistemi i hedhjes së vlerësimit monitoron në kohë reale ndërhyrjet në sistem. Ky informacion vlerësohet dhe raportohet në organet drejtuese.</p> <p>Nga konstatimi i GVJ, faqja e internetit e institucionit përfshin informacionin lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme. Përveç kësaj, UMT është shumë aktive edhe në rrjetet sociale, në të cilat ka gjithnjë informacione lidhur me programin si dhe me aktivitete të tjera që organizon Universiteti dhe Fakulteti i Ekonomisë. Një pjesë e këtyre njoftimeve janë të emetuara në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht.</p>
--	--

	Aneks 43; Aneks93; Aneks 103			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ, referuar dokumentacionit të përcjellë, konstaton se UMT harton një plan financiar ku elementi kyç është llogaritja e kostos për student. Për vetë faktin e një numri shumë të ulët të studentëve gjatë këtyre dy viteve që ka startuar programi, kjo kosto është e lartë dhe rimburohet nga aksioneri i shoqërisë.  <i>Aneks 118</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Sipas së njëjtës evidencë, në planin financiar përfshihen: <ul style="list-style-type: none"> <li>Të ardhurat e programit nga tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, shërbime të ndryshme të IAL, burime të tjera, ku përqindjen më të madhe e zënë dy kategoritë e para. Si një IAL jopublik rreth 97 % e të ardhurave të institucionit vjen nga tarifat e studimit;</li> <li>Shpenzimet e planifikuara sipas zërave standard. Në këtë plan financiar janë parashikuar orët e mësimdhënies dhe elementët e tjerë të kostos së programit. Të gjitha kategoritë e kriterit janë të përfshira në këtë plan.</li> </ul> <i>Aneks 118</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Institucioni ka kryer auditime të jashtme të përvitshme; në to janë evidentuar ecuritë dhe problemet financiare, <i>por nuk ka një raport të mirëfilltë të rregullimit të parregullsive dhe nuk ka informacion të posaçëm për këtë program studimi për të cilin hartohet ky raport.</i>  <i>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, përveç raporteve financiare, nuk u vërejt ndonjë dokumentacion që tregon ecurinë në vazhdimësi të programit lidhur me financimin e tij, me vështirësitë me nevojat e posaçme apo lidhur me vështirësitë që has realizimi i</i>

	<i>këtij programi të studimit.</i> <i>Aneks 129</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Institucioni harton raportin për tre vitet e kaluara për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si dhe nivelin e shpenzimeve. Raporti financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare.  Referuar RVB-së konstatohet se në mënyrë periodike Zyra e Financës pranë UMT-së bën relacion mbi projekt buxhetin me qëllim që të kontrollojë mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes së studimeve si dhe të identifikojë burimet e mundshme të gjenerimit të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.  <i>Aneks 128</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Pavarësisht qëndrueshmërisë financiare të IAL (pra në nivel Fakulteti/Universiteti) e cila nuk ka pasur problem deri tani, rritja e numrit të studentëve në të ardhmen afatshkurtër do të siguronte qëndrueshmërinë e programit dhe do kontribuonte më tej në qëndrueshmërinë financiare të institucionit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik	Institucioni krahas zbatimit të akteve ligjore në fuqi, ka përcaktuar politikat dhe procedurat përkatëse lidhur me procesin e hyrjes së

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salha*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Drini Salha*

<p>të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>studentëve, realizimit të programit dhe diplomimit të tyre. Në funksion të kësaj, krahas statutit, janë edhe rregullorja e institucionit, rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë dhe Rregullorja e vetë programit të studimit. Në nene të veçanta të këtyre akteve nënligjore dhe rregullative janë të përcaktuara të gjitha procedurat që shoqërojnë ecurinë e studentit në hyrje, zhvillim dhe përfundim të programit. Gjithashtu, institucioni ka vendime të veçanta mbi procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit të programeve në UMT si dhe kriteret mbi të cilat bazohet ky proces.</p> <p><i>Aneks 1; Aneks 30; Aneks 31; Aneks 32; Aneks 33; Aneks 35; Aneks 36; Aneks 50</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe sidomos intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat e ndjekura nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti Financë-Bankë, Rektorat, Senat Akademik) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UMT.</p> <p><i>Aneks 31; Aneks 34; Aneks 50</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UMT, të Fakultetit të Ekonomisë si dhe të programit të studimit. Në këtë program studimi nuk na rezultoi që të kishte pasur largime apo transferime studentësh, kjo edhe për periudhën e shkurtër dy vjeçare që ai është në zhvillim. Në aktet rregullatore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë janë të përcaktuara qartë kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve.</p> <p><i>Aneks 30; Aneks 50</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në vendimet e Senatit Akademik dt. 13.01.2017 dhe dt. 31.03.2017 dhe të Rektoratit dt. 28.02.2019 si dhe referuar vizitës në institucion dhe dokumentacionit të venë në dispozicion, GVJ konstaton se UMT miraton para fillimit të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret përkatëse. Në funksion të këtij qëllimi me vendim Rektorati përcaktohet dhe Komisioni që ndjek këtë proces.</p> <p><i>Aneks 31; Aneks 32; Aneks 33</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>U verifikua që informacioni i mësipërm behet publik në faqen zyrtare të UMT, përfshirë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. Edhe guida e studentit e përgatitur paraprakisht është një mjet shtesë në arritjen e këtij qëllimi.</p> <p><i>Aneks 31</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e regjistruar në këtë program marrin informacion lidhur me ecurinë apo progresin akademik kryesisht përmes përdorimit të sistemit informativ që u mundëson atyre të shohin rezultatet e vlerësimit si dhe të frekuentimit. Kjo u konfirmua nga takimi me studentët e programit. Gjithashtu, studentët marrin informacione dhe në faqen zyrtare të pedagogut përkatës, apo rrjeteve të emaileve të tyre <i>(e konfirmuar nga studentët)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Për vetë historikun e shkurtër të këtij programi nuk u evidentua rast injohjes së kualifikimeve të mëparshme, por u evidentuan praktika të tilla me studentë të programeve të tjera. Për njohje të krediteve lidhur me transferimet, Fakulteti i Ekonomisë ngrën një Komision të posaçëm që vlerëson dhe njehkëto kredite. Një rast konkret i kësaj procedure u evidentua edhe gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>Aneks 30; Aneks 90</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon</p>	<p>Forma kryesore e informimit të studentëve lidhur me vlerësimin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	dijeve janë programi informatik, siti personal i pedagogut të lëndës, rrjeti i email-ave domen e UMT ( <a href="mailto:e.mbiemri@umt.edu.al">e.mbiemri@umt.edu.al</a> ) të tyre si dhe komunikimi i drejtpërdrejtë në takime studentë-pedagogë, sidomos në periudhën pas provimit kur ende rezultati nuk është konfirmuar përfundimisht ( <i>takimi me studentët e programit</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga takimi me studentët e Kursit të II-të të këtij programi (të katërt që ishin prezentë) u konfirmua se ata ishin njohur me kriteret dhe procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të mikrotezës që në fillim të vitit të dytë si nëpërmjet udhëzuesit të institucionit, ashtu edhe nga pedagogët përkatës dhe njëkohësisht udhëheqës të punimeve të tyre. Gjithashtu, një informacion në këtë drejtim studentët marrin edhe nga faqja e internetit të UMT. <i>Aneks 64; Aneks 65</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Që gjatë procesit të aplikimit dhenë vazhdimësi, studentët marrin informacione në institucion nëpërmjet takimeve pranë zyrës së informacionit në sekretari, udhëzuesit të studentëve, webit të institucionit, etj. <i>Duke u nisur nga fakti që numri i studentëve në këtë program gjatë dy viteve të fundit që ai ka nisur të zhvillohet është i ulët, mendojmë se një informim specifik dhe një marketing i targetuar për studentët potencial të këtij programi, duhet të jetë më intensiv me qëllim përmbushjen e një kuote optimale studentësh.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Universiteti aplikon forma të ndryshme të informimit të studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Këtu përfshihen krahas takimeve informuese me informacionin që merret në fazën e aplikimit (zyra e karrierës dhe shërbimit të studentëve) edhe mundësi për tu njohur mbi aspekte të ndryshme të programit. Kjo arrihet nëpërmjet shpalljes së programit, strukturës së tij dhe syllabusve, të cilat japin informacion të hollësishëm si dhe takimit të pedagogut të lëndës në prezantimin e parë që ai bën në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

*Dr. Miri Sallku*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Mirë*



	fillim të semestrit. <i>Aneks 56</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Guida e studentit, informacioni në vend dhe informimi paraprak në webin e UMT, i shërbejnë periudhës para regjistrimit të studentëve. Pas kësaj studentët marrin informacion të plotë dhe periodik dhe të hollësishëm mbi përmbajtjen e programit, detyrimet që kanë të bëjnë me frekuentimin, vlerësimin gjatë vitit, në fund, etj.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion në takimin me zyrën e këshillimit të studentëve dhe Alumn-it, ata marrin informacion mbi mundësinë e punësimit pas diplomimit të tyre. Si bazë shërben edhe studimi i tregut të realizuar në institucion..			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni i nevojshëm për studentet përditësohet dhe ata e kanë mundësinë ta marrin nëpërmjet të gjitha formave të përmendura më lart. <i>Aneks 56</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i informacionit me të gjitha format e analizuara me lart është i arritshëm edhe nga studentët në distancë. Edhe ngatakimi me studentët e programit, opinionin e tyre mbi lehtësinë e marrjes së informacionit ishte pozitiv.			
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Nëpërmjet sistemit të brendshëmve të menaxhimit arrihet të administrohet informacioni dhe dokumentacioni mbi aktivitetin mësimor të studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatikë të brendshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e	Bazuar në dokumentacion dhe vizitën në institucion në takimin në sekretarinëmësimore, u evidentua mbajtja e statistikave vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në disa programe studimi. Në këtë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Drini Salko*

studimit.	program nuk kemi studentë të diplomuar pasi është viti i II-të që ky program zhvillohet dhe mbrojtja e diplomës nuk ka përfunduar (për shkak të situatës pandemike). <i>Aneks 87; Aneks 95; Aneks 114</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Sipas dokumentacionit të përcjellë dhe vizitës në institucion, u evidentua mbajtja e statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në program, largimet para përfundimit të. Kjo u evidentua dhe konfirmua edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, në regjistrin themeltartë studentëve të këtij programi. <i>Aneks 87; Aneks 95; Aneks 114</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Gjatë vizitës në institucion në sekretarinë mësimore, u evidentua gjithashtu mbajtja e statistikave vjetore për ecurinë mësimore të studentëve të regjistruar në program deri në stadin aktual për këtë program studimi. Në regjistrin mësimor të studentëve ishin vendosur të gjitha vlerësimet e tyre, përfshirë edhe praktikën.			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit ku edhe ruhet konfidencialiteti. U evidentuan dy praktika studentësh të këtij programi lidhur me informacionin statistikor të procesit mësimor dhe progresit të tyre deri në fazën aktuale. <i>Aneks 87; Aneks 95; Aneks 114</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Institucioni dhe njësia kryesore/bazë hartojnë raportet vjetore të analizës mësimore shkencore të hallkave përkatëse, ku në to gjejnë pasqyrim trajtimet e procesit mësimor, cilësia e hyrjeve dhe daljeve të studentëve si dhe detyrat në të ardhmen. <i>Aneks 73</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon	UMT, në zbatim të ligjit 80/2015 dhe të statutit të tij, u garanton

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dr. Miri Sallha*

*Mirë*

<p>përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatorë të vetë IAL-ve.</p>	<p>studentëve përfaqësim në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese si: Senat Akademik, NJSBC, Grupet e Vetëvlerësimit në kuadër të proceseve të akreditimit të programeve, etj.</p> <p>U evidentua pjesëmarrja e studentëve në këto organe vendimmarrëse dhe pjesëmarrja e tyre në takimet që ato zhvillonin nëpërmjet vendimeve përkatëse të ngritjes së këtyre strukturave.</p> <p><i>Mendojmë që roli i Këshillit Studentor dhe i përfaqësuesve të studentëve në këto njësi vendimmarrëse, nevojitet të jetë më aktiv dhe frutdhënës.</i></p> <p><i>Aneks 1; Aneks 2</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve, duke u bazuar në kriteret e ngarkesësmësimore bazuar në kredite. Kjo u konfirmua edhe në takimin me stafin e Departamentit që mbulon programin, si dhe me studentët.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Hartimi i programit të studimit të ciklit të dytë MSH në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” është bërë në përputhje me bazën ligjore në fuqi për hapjen e programeve të studimit dhe udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. <i>Për vetë periudhën e shkurtër të këtij programi dhe numrin e pakët të studentëve nuk është bërë ndonjë përmirësim në program ku të kishte edhe rol të studentëve.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga takimi me studentet nuk u evidentua ndonjë reklamim i tyre lidhur me vlerësimin e dijeve nga pedagoget, por ata shprehën opinion pozitiv për vlerësimet e dijeve të tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

**Standardi V.6**

**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

**e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe vizitën në Institucion, evidentohet fakti i angazhimit të stafit akademik në veprimtari kërkimore shkencore. Kjo duke analizuar, krahas raporteve vjetore të punës kërkimore shkencore në njësinë kryesor/bazë, edhe formularin e performancës akademike të stafit që mban njësia kryesore/bazë, NJSBC dhe Zyra e Burimeve Njerëzore. Bazuar ne raportin e kërkimit shkencor të institucionit, rezulton se gjatë periudhës 2017-2020 numri i botimeve të personelit akademik efektiv është mbi 100; numri i projekteve të fituara 6; numri i aktiviteteve shkencore të organizuara 7. <i>Numri i studentëve të përfshirë në këto aktivitete, në rang institucioni, është rreth 95, por nuk ka studentë të këtij programi.</i> <i>Aneks 93</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe takimin me zyrën e projekteve, u evidentua se UMT ka qenë aktive në lidhjen e marrëveshjeve me institucione homologe të huaja (janë 4 të tilla) si dhe me një numër institucionesh të tjera të vendit dhe të huaja. <i>Aneks 22; Aneks 24</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Sipas vizitës në Institucion, personeli akademik inkurajon studentët të shkruajnë dhe botojnë studime punimi shkencore. Kjo përgjithësisht është realizuar në bashkëpunim pedagog udhëheqës-student gjatë përgatitjeve të punimeve të mikrotezave. Gjithashtu, u evidentuan raste të përdorimit të mobiliteteve të studentëve pranë universiteteve të huaja që janë shfrytëzuar në përgatitje të punimeve të mikrotezave.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Stafi akademik inkurajohet për të realizuar botime në revista shkencore të vendit dhe të huaja. Evidentohet një rast i mbështetjes financiare të institucionit të botimeve të stafit të këtij programi ku është financuar pjesëmarrja në Konferencë shkencore. <i>Bazuar në raportin e kërkimit shkencor, studentët janë përfshirë në bashkëpunim me stafin në punime shkencore, ku janë evidentuar 15 studentë, por që nuk janë nga studentët e këtij programi.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p><i>Nisur nga stadi aktual i zhvillimit të institucionit në përgjithësi dhe nivelit të stafit akademik të tij në veçanti, mendojmë se mbështetja financiare e botimeve të stafit akademik duhet të jetë më e madhe dhe e specifikuar si nënë i zërit të buxhetit “Shpenzime kërkim</i></p>

	<p>zhvillimi” që evidentohet në buxhetin e vitit 2019-2020.</p> <p>Siç është përmendur edhe më lart, Institucioni dhe stafi akademik inkurajojnë studentët në studime inovative ku duhet theksuar projekti i inkubatorit të marketingut.</p> <p>Megjithatë, mendojmë se studentë të këtij programi, apo edhe të programeve të tjera MSH që kanë një nivel relativisht të lartë përgatitje kërkimore-shkencore, duhet të angazhohen më shumë nga stafi akademik dhe të kenë botime qoftë edhe të përbashkëta më shumë në numër.</p> <p>Aneks 93; Aneks 128</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>U evidentua nga takimi me studentët e programit se asistencë kryesore e stafit akademik në këtë drejtim realizohet gjatë përgatitjeve të detyrave të kursit apo punimeve të diplomës së studentëve, duke shfrytëzuar infrastrukturën që ofron institucioni.</p> <p>Aneks 65</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi V.7</b>  <b>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të programit dhe syllabuseve të lëndëve që përfshin ky program, evidentohet niveliteorik shkencor itij. Në këtë këndvështrim, në shumicën e lëndëve karakterizuese të programit, dominon përdorimi i metodave bashkëkohore të kërkimit dhe i programeve që ndihmojnë në përdorimin e këtyre metodave.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Nga ana tjetër, shqyrtimi i CV të personelit akademik tregon për nivelin e duhur shkencor që ata kanë si premisë e përcjelljes së njohurive të thelluara që ata japin në këtë program. Mbi këtë bazë programi plotëson kriterin për ti shërbyer programit të ciklit të tretë të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të hu</p>	<p>Nga takimi me stafin, u evidentuan raste të përfshirjes së stafit të ri në projektet kërkimore ku UMT është pjesëmarrës. Në grupet pjesëmarrëse në këto projekte ka përfshirje të stafit me eksperiencë të gjatë me ata me eksperiencë relativisht të re.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Mendojmë që, në funksion të kriterëve të mësipërme, institucioni</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Dr. Miri Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*Mirë*

<b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	<i>duhet të intensifikojë punën duke angazhuar si lektorë të ftuar apo bashkëpunëtor në projekte, sidomos në fushën e financës, personel akademik të huaj duke i paraprirë kështu rritjes së bashkëpunimit edhe në fushën e këtij programi relativisht të ri për institucionin. Gjithashtu, të arrihet që të vinë në kuadër të projekteve të ndryshme (psh.mobiliteteve tëERASMUS) studentë të huaj.</i> <i>Aneks 27; Aneks 72; Tabela 20</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Bazuar në organigramen e UMT rezulton që në funksion të informacionit dhe shërbimit për studentët, institucioni ka struktura që kanë objektetë funksion, akte rregullative të miratuara nga strukturat vendimmarrëse, si dhe përdor metoda në përputhje me të. Në rektorat funksionon Zyra e Informimit të Studentëve dhe publikut, që ndjek informimin e studentëve në forma të ndryshme si: guidën e studentit, fletëpalosje, njoftime në webin e UMT, etj. Një sërë aktesh të brendshme rregullative adresojnë problematikën e informimit dhe mundësinë e ankimimit të studentëve gjatë zhvillimit të programeve mësimore të tilla si: rregullorja e Fakultetit, rregullorja e Sekretarisë, rregullorja e programit të studimit, rregullorja e provimeve, etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në faqen e web-it të institucionit jepen një sërë informacionesh për studentët. Gjatë vizitës në institucion u informuam që kjo faqe është në proces përditësimi. Një strukturë tjetër lidhur me këtë kriter është dhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe Alumni që ofron informacion për mundësitë e punësimit, të trajnimeve, praktikave etj.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<i>Aneks 36;Aneks 50; Aneks 77;Aneks 78;Aneks 79;Aneks 127</i>
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

*Drini Salko*

punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UMT, në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, pika 1, ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë qe është NJSBC, strukturë në nivel institucioni.  <i>Në planin e zhvillimit të institucionit trajtohet parimisht edhe ngritja e cilësisë së programeve të studimit, por që për një orientim me të qartë të NJSBC në këtë dokument mund të ishin më të plota politikat dhe drejtimit kryesore të rritjes së cilësisë.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.	Në NJSBC, krahas stafit akademik bën pjesë dhe përfaqësuesi i studentëve. Kjo strukturë koordinon punën me njësitë kryesore/bazë kryesisht me koordinatorin e fakultetit përkatësi dhe departamentet në to. Bazuar në rregulloren e saj metodat e vlerësimit nga NJSBC janë anketimet/takimet me studentët, diskutimet me koordinatorët e programeve, etj. Kjo njësi mbi bazën e informacioneve të marra harton raportin periodik, problematikat e të cilit u bëhen prezent strukturave përkatëse në nivel institucional, Fakulteti dhe Departamenti.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Drini Salko*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


*Drini Salko*

përmirësojnë cilësinë.	Lidhur me cilësinë e mësimdhënies, nga kjo njësi sigurohet informacioni i performancës akademike të stafit akademik në mënyrë periodike vjetore plotësohet në nivel Departamenti. U evidentuan dy praktika të vlerësimit të performancës së stafit akademik e materializuar në skedën përkatëse. Kjo skedë përfshin jo vetëm vlerësimin akademik, por edhe veprimtarinë kërkimore shkencore.			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjveve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Vlerësimi i jashtëm i cilësisë për UMT realizohet nëpërmjet nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit, për programet e akredituara apo të licencuara deri tani. Institucioni ka marrë akreditimin në vitin 2017 ku rol ka pasur vlerësimi i jashtëm institucional nga QAA dhe ASCAL dhe në 26.07.2019 mori akreditimin në nivel Universiteti (me kohëzgjatje të vlefshmërisë së akreditimit deri në vitin 2022).</p> <p><i>Mendojmë se NJSBC do të duhet që institucioni të hartojë politika më të plota dhe më të detajuara lidhur me ngritjen e mëtejshme të cilësisë së programeve të studimit që zhvillohen në institucion dhe natyrisht edhe për këtë program që GVJ po vlerëson.</i></p> <p><i>Aneks 3; Aneks 7; Aneks 8; Aneks 9; Aneks 13</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjveve të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Njësia bazë që është Departamenti Financë-Bankë, ka qenë dhe është struktura kryesore e hartimit të këtij programi, por edhe e monitorimit të ecurisë së tij gjatë këtyre dy viteve që ky program po zhvillohet.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Në diskutime me stafin u dakordësua nevoja e përmirësimeve të mëtejshme të programit tashmë që ai po mbyll ciklin e plotë dy vjeçar. Akreditimi i këtij programi do japë mundësi që Departamenti Financë-Bankë të mundësojë përmirësimet e mëtejshme në program në kuadër të hapësirës së lejuar. Eksperiencia e këtyre dy viteve të zhvillimit të programit ka bërë që si rrjedhojë e monitorimit nga
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi,	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	njësia bazë, të bëhet e mundur edhe përmirësimi i syllabuseve, por edhe i strukturës së mësimdhënies në lëndë të veçanta duke rritur peshën e trajtimeve aplikative.			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Ecuria e këtij programi dhe problematika lidhur me të janë diskutuar në mbledhjet e Departamentit.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Monitorimi i programit dhe rezultatet e tij të dalin nga disa forma monitorimi (anketimet me studentë, diskutimi në departament, opinioni i koordinatorit të programit, etj.) i janë përcjellë NJSBC. <i>Aneks 73; Aneks 81; Aneks 122; Tabela 21</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Njësia që ka ndjekur procesin e hapjes, vlerësimit dhe monitorimit për këtë program është Departamenti Financë-Bankë. Në raportet vjetore të kësaj njësi evidentohen dhe rezultat e vlerësimit për programin që dalin nga format e ndryshme direkte dhe indirekte të vlerësimit të mësimdhënies. Departamenti dhe koordinatori i programit bashkëpunon me NJSBC në dhënie dhe marrje informacioni, bazuar në raportet periodike të tyre. Një formë direkt monitorimi është edhe aplikimi në disa raste i pjesëmarrjes së grupit të monitorimit në procesin e mësimdhënies në auditor. Në fund të mësimit grupi monitorues plotëson formularin e zhvillimit të mësimin ku vlerësohet ky proces. Takimet e drejtpërdrejta dhe realizimi i anketimeve me studentët janë forma të tjera të monitorimit të mësimdhënies.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	GVJ, gjatë vizitës në institucion, pati takim dhe diskutim me grupin ad-hoc të vlerësimit të brendshëm në kuadër të këtij akreditimi, i cili ka përfshirë në raport edhe rezultatet e monitorimit direkt dhe indirekt të programit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së	<i>Vetë historiku i shkurtër i këtij programi e bën të domosdoshëm</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

*Divina Salha*

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*ASCA*

<p>mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>monitorimin më të thelluar në të ardhmen dhe vlerësimin më të saktë për këtë program, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tij në funksion jo vetëm të rritjes së numrit të studentëve të ardhshëm në program, por dhe të thithjes nga tregu i punës të kontingjentëve të studentëve të diplomuarne bachelor edhe nga programet e shkencave inxhinerike, dy sfidat kryesore të tij.</i></p> <p>Ky rekomandim i GVJ ka të bëjë me periudhën afatshkurtër të programit dhe përmirësimin e mëtejshëm të tij në të ardhmen për rritjen e numrit të studentëve në këtë program.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p><i>Aneks 7; Aneks 8; Aneks 81; Aneks 93; Aneks 115</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi VI.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UMT në procesin e SBC- së përfshin njësi akademike, stafin dhe studentët si dhe informon institucionet përkatëse për këtë vlerësim. Ky proces është ndjekur nga NJSBC, Departamenti që mbulon këtë program, koordinatori i programit që në përbërjen e tyre kanë staf akademik dhe përfaqësues të studentëve .</p> <p>Në rregulloret përkatëse të institucionit, NJSBC, Fakultetit dhe vetë programit janë të përcaktuara roli dhe përgjegjësia e të gjithë njësive të përfshira në monitorim dhe vlerësim të programit. Në evidencën nr.8 është pasqyruar përbërja e NJBSC: 6 anëtar stafi dhe një</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	student, dhe në evidencën nr.9 është rregullorja e kësaj njësie, ku janë përcaktuar dhe politikat në fushën e cilësisë.			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	<i>Përnjë ndjekje, monitorim dhe vlerësim më të mirë të këtij programi, por jo vetëm, do të rekomandonim ngritjen e një Komisioni të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në nivel Fakulteti të Ekonomisë, që të këtë në përbërje staf të njësisë kryesore (Fakultetit) dhe studentë të këtij programi mësimor. Kjo do të rriste më tej përgjegjësinë por dhe profesionalizmin në monitorim, por para së gjithash në vlerësimin e cilësisë së programit. Po kështu, të mundësohet marrja e opinionëve dhe vlerësimeve nga ekspertë të jashtëm që e njohin këtë fushë studimi dhe që kane eksperience në vlerësim programesh dhe monitorim të procesit mësimdhënies, gjë që nuk është aplikuar nga institucioni për këtë program.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<i>Aneks2;Aneks 9;Aneks 10; Aneks 11; Aneks 12;Aneks 50</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në aktet rregullative të institucionit si rregulloren e tij, rregulloren e NJSBC, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë trajtohen deri diku edhe transparenca e rezultateve lidhur me SBC. Gjetjet dhe problematikat e dala nga raportet periodike të njësisë përkatëse adresohen pranë njësisë kryesore dhe bazë për tu diskutuar dhe dhënë zgjidhje më të mira në funksion të rritjes së cilësisë.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p><i>Mendojmë që strukturat e vlerësimit të cilësisë dhe sidomos NJSBC duhet të adresojnë më drejtpërdrejt dhe më hollësisht problematiken e dalë. Nga ana tjetër, për vetë historikun e shkurtër të këtij programi dhe numrin e ulët të studentëve edhe vlerësimet e të gjitha strukturave lidhur me vlerësimin do të konsideronim jo të plota në funksion të qëllimit të tyre.</i></p> <p><i>Aneks 2; Aneks 9; Aneks 50</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Metropolitan Tirana”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit është pothuajse unik pasi gërsheton njohuritë e inxhinierisë financiare me ato të menaxhimit të riskut dhe u jep mundësi studimi edhe studentëve që kanë përfunduar studimet në inxhinieri dhe informatikë, krahas atyre që kanë mbaruar në ekonomi apo financë.
2. Realizimi i një procesi mësimdhënieje, vlerësimi dhe kompetence akademike efektiv, e pavarur dhe me cilësi.
3. Vendndodhje strategjike e universitetit dhe infrastrukturë e përshtatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve, praktikave, akomodimin e studentëve, etj.

**Pika të dobëta:**

1. Studimi i tregut, në pjesën me të madhe të tij, është i përgjithshëm dhe mungojnë pjesërisht referencat e nevojave të tregut për specialistët që përfundojnë këtë program dhe që kanë veçori në kompetencat e tyre të cilat mund të ofrohen në vende specifike dhe delikate të sistemit financiar.
2. Për disa fusha mungon literatura, në disa tekste universitare numri i ekzemplarëve është i limituar, si dhe në disa lëndë të caktuara të programit të studimit, kryesisht ato të karakterit aplikativ, literatura e huaj është e kufizuar. Gjithashtu, hapësira në Bibliotekën e Institucionit është jo optimale në funksion të qëllimit të saj.
3. Disa prej pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi kanë një ngarkesë mësimore relativisht të lartë lidhur kjo me numrin e lëndëve që mbulojnë.
4. Numri i kufizuar i marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me institucione homologe jashtë vendit në kuadër të projekteve të BE dhe më gjerë.
5. Politikat e hartuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë lidhur me rritjen e mëtejshme të cilësisë së programeve të studimit që zhvillohen në institucion dhe natyrisht edhe për këtë program studimi nuk janë të plota e të detajuara.
6. Nuk rezulton që të jenë përdorur forma të tjera për kualifikimin akademik dhe profesional të stafit, veçanërisht në fushën e aftësimin pedagogjik dhe në atë të komunikimit.

**Rekomandime:**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



1. Institucioni, për vetë specifikën dhe rëndësinë e këtij programi që është pothuajse unik, të ndërmarrë një studim të veçantë të tregut për të diplomuarit e ardhshëm në këtë program. Kjo do të mundësojë jo vetëm njohjen e drejtpërdrejtë të tregut nga institucioni, por krijon dhe lidhjen e duhur me tregun e punës e cila mund të krijojë mundësinë e marrëveshjeve mes institucionit dhe punëdhënësve potencial për të diplomuarit në këtë program.
2. Për përmirësim të mëtejshëm të programit të studimit në të ardhmen, Institucioni mund të pasqyrojë në planin mësimor disa ndryshime si në vijim:
  - Bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperiencën të programeve në Universitete të tjera, mund të pasqyrojë ndryshime në numrin e krediteve të përcaktuara për lëndët e këtij programi, në funksion të ngarkesës (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit, në përputhje me natyrën apo fushën që përfshijnë në trajtim;
  - Për të qenë më fleksibël, mund të aplikohen disa lëndë me zgjedhje sidomos në semestrin e I-rë të vitit të dytë, duke rritur mundësinë që studentët të “profilizohen” në drejtime të caktuara, qoftë edhe në funksion të punimit të mikrotezës;
  - Meqenëse ky program është atraktiv edhe për studentë që kanë mbaruar studime joekonomike (inxhinieri, matematikë, informatikë, etj.) për këta studentë mund të shtoheshin lëndë bazike të fushës së ekonomisë apo financës, duke u mundësuar atyre të përvetësojnë më lehtë dhe plotësisht lëndë të financës që kanë njohuri të avancuara dhe që kërkojnë baza teorike të marra më parë;
  - Mund të rregullohet rradha e zhvillimit të lëndëve të veçanta. Kështu psh. lënda “Menaxhim i Riskut dhe Vlerësimi” që zhvillohet në semestrin e dytë të kursit të I-rë, mund të ndërrohet vendin me lëndën “Strategjia e Menaxhimit të Riskut”, që logjikisht zhvillohet e dyta. Gjithashtu, lënda “Statistikë financiare” mund të zhvillohet përpara lëndës “Strukturë të dhënash dhe algoritmesh financiare”, duke ruajtur logjikën e marrjes së njohurive.
3. Institucioni:
  - të shtojë fondin e librave me tekste në shqip por edhe në anglisht për lëndët karakterizuese të programit, me qëllim që leksionet e parashkruara që janë përgatitur nga stafi të plotësohen me këto tekste;
  - të shtojë literaturën e huaj në lëndë të caktuara të programit, kryesisht ato të karakterit aplikativ, sidomos ajo në formën e manualeve dhe rasteve të studimit që i jep një karakter më praktik trajtimit të problematikës;
  - të rrisë hapësirën fizike në dispozicion të Bibliotekës, për një funksionim sa më optimal të saj.
4. Institucioni, të angazhojë në mësimdhënie në këtë program studimi personel akademik me të paktën gradë shkencore “Doktor” dhe të përcaktojë si titullarë lëndësh personel

akademik të kategorisë “Profesor”, në përputhje me parashikimet ligjore në Nenin 59, pika 3 dhe 6 të Ligjit 80/2015.

5. Institucioni, në interes të rritjes së nivelit të cilësisë së mësimdhënies, të rrisë numrin e personelit akademik me kohë të plotë nëpërmjet rekrutimeve të reja, me qëllim uljen e ngarkesës në numër lëndësh të personelit akademik aktual.
6. Institucioni, të rrisë mbështetjen financiare për botime të stafit akademik, duke e specifikuar edhe si nënzë të zërit të buxhetit “Shpenzime kërkim zhvillimi” që evidentohet në buxhet, si dhe të nxisë më tepër angazhimin dhe pjesëmarrjen e studentëve të këtij programi në botime të stafit, konferenca shkencore, projekte apo programe mobiliteti.
7. Institucioni, të rrisë më tej numrin e marrëveshjeve me Universitete homologe të huaja dhe sidomos me ato universitete të huaja që zhvillojnë këtë program studimi, si dhe të intensifikojë përpjekjet për të rritur dhe konsoliduar marrëveshjet me institucione kryesisht financiare e bankare, duke saktësuar e specifikuar sektorin apo drejtoritë e riskut dhe modelimeve, vende këto që justifikojnë njohuritë e marra në këtë program dhe pse jo, të kishte edhe angazhim konkret në procesin e mësimdhënies nga përfaqësues të këtyre institucioneve.
8. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të hartojë politika më të plota e të detajuara lidhur me rritjen e mëtejshme të cilësisë, monitorimin më të thelluar dhe vlerësimin më të saktë për këtë program studimi, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tij, si dhe së bashku me strukturat e tjera, të adresojë më drejtpërdrejt dhe më hollësisht problematikën e dalë. Gjithashtu, Institucioni, për një ndjekje, monitorim dhe vlerësim më të mirë të këtij programi, por jo vetëm, të shohë mundësinë e ngritjes së një Komisioni të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në nivel njësie kryesore, që të këtë në përbërje staf të kësaj njësie dhe studentë të këtij programi studimi.
9. Institucioni, të mundësojë realizimin e trajnimeve specifike të stafit akademik të programit të studimit, veçanërisht në fushën e aftësimin pedagogjik dhe metodikave inovative të mësimdhënies.
10. Institucioni, të realizojë një informim specifik dhe një marketing të targetuar për studentët potencial të këtij programi më intensiv me qëllim përmbushjen e një kuote optimale studentësh.

**Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle  
Master of Science in “Financial Engineering and Risk Management”, of the  
Institution of Higher Education “Metropolitan Tirana” University**

**Strengths and affirmations:**

1. The study program is almost unique as it combines the knowledge of financial engineering with those of risk management and gives study opportunities to students who have completed studies in engineering and informatics, in addition to those who have graduated in economics or finance.
2. Realization of an effective, independent and quality teaching process, evaluation and academic competence.
3. Strategic location of the university and appropriate infrastructure for the development of lectures / seminars, internships, student accommodation, etc.

**Weaknesses:**

1. The market study, in the most part of it, is general and partially lacks the references of market needs for specialists who complete this program and have peculiarities in their competencies which can be offered in specific and delicate places of the financial system.
2. For some fields there is a lack of literature, in some university texts the number of copies is limited, as well as in certain subjects of the study program, mainly those of applied character, foreign literature is limited. Also, the space in the Library of the Institution is not optimal in function of its purpose.
3. Some of the lecturers engaged in this study program have a relatively high teaching load in relation to the number of courses they cover.
4. Limited number of cooperation agreements in the field of teaching and research with counterpart institutions abroad in the framework of EU projects and beyond.
5. The policies compiled by the Internal Quality Assurance Unit regarding the further increase of the quality of the study programs that are developed in the institution and of course for this study program are not complete and detailed.
6. Does not result that other forms have been used for the academic and professional qualification of the staff, especially in the field of pedagogical training and communication.



## Recommendations:

1. The institution, for the very specificity and importance of this program which is almost unique, has to undertake a special market study for future graduates in this program. This will enable not only the direct knowledge of the market by the institution, but also creates the right connection with the labor market which can create the possibility of agreements between the institution and potential employers for graduates in this program.
2. For further improvement of the study program in the future, the Institution may reflect in the curriculum some changes as follows:
  - Based on the methodology of determining credits for specific courses as well as in many experiences of programs at other Universities, may reflect changes in the number of credits allocated for courses of this program, depending on the load (commitment) in the auditorium and outside of the student, in accordance with the nature or scope of the treatment;
  - To be more flexible, some elective courses can be applied, especially in the first semester of the second year, increasing the possibility for students to be "profiled" in certain areas, even in function of microthesis work;
  - Since this program is attractive even for students who have completed non-economic studies (engineering, mathematics, computer science, etc.) for these students could be added basic courses in the field of economics or finance, enabling them to more easily and fully acquire finance courses that have advanced knowledge and require previously acquired theoretical basis;
  - The order of realization of special subjects can be adjusted. Thus e.g. "Risk Management and Evaluation" subject that takes place in the second semester of the 1st course, can change place with the "Risk Management Strategy" subject, which logically is done as the second one. Also, the "Financial Statistics" subject can be done before the "Data structure and financial algorithms" subject, maintaining the logic of obtaining knowledge.
3. Institution should:
  - increase the fund of books with texts in Albanian but also in English for the characteristic subjects of the program, in order for the prescribed lectures that have been prepared by the staff to be supplemented with these texts;
  - add foreign literature in certain subjects of the program, mainly those of applied character, especially that in the form of manuals and case studies that give a more practical character to the treatment of problems;
  - increase the physical space available for the Library, for a more optimal functioning.
4. The institution has to engage in teaching in this study program academic staff with at least "PhD" scientific degree and to determine as course holders academic staff of the "Professor" category, in accordance with the legal provisions in Article 59, points 3 and 6 of Law 80/2015.

5. The institution, in the interest of increasing the level of teaching quality, should increase the number of full-time academic staff through new recruitments, in order to reduce the workload of the current academic staff in number of subjects.
6. The institution should increase the financial support for publications of the academic staff, specifying it as a sub-item of the budget “Development research expenditures” that is evidenced in the budget, as well as to further encourage the engagement and participation of students of this program in publications of the staff, scientific conferences, projects or mobility programs.
7. The institution should further increase the number of agreements with foreign counterpart Universities and especially with those foreign universities that develop this study program, as well as to intensify efforts to increase and consolidate agreements with institutions mainly financial and banking, specifying the sector or directorates of risk and modeling, countries that justify the knowledge obtained in this program and why not, to have a concrete engagement in the teaching process by representatives of these institutions.
8. The Internal Quality Assurance Unit has to compile more complete and detailed policies regarding further quality enhancement, more in-depth monitoring and more accurate evaluation of this study program, in order to further improve it, as well as together with other structures, to address more directly and in more detail the raised issues. Also, the Institution, for a better monitoring and evaluation of this program, but not only, to see the possibility of setting up a Permanent Quality Assurance Commission at the level of the main unit, to be composed of staff of this unit and students of this study program.
9. The institution should enable the realization of specific trainings of the academic staff of the study program, especially in the field of pedagogical training and innovative teaching methodologies.
10. The institution should realize a specific information and a more intensive targeted marketing for potential students of this program in order to meet an optimal student quota.

### **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. Dr. Drini SALKO

*Drini Salko*

2. Prof. As. Dr. Besnik KRASNIQI

*Besnik Krasniqi*

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				<b>X</b>
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			<b>X</b>	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				<b>X</b>
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				<b>X</b>
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			<b>X</b>	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>